

DOKUMENT POLITIKASH



“Efikasiteti i procedurave të azilit dhe sfidat e ndeshura nga ana e institucioneve vendase për trajtimin dhe menaxhimin e migrantëve të parregullt”



unicef 
for every child

C1-EU-NPA
CLUSTER ONE EU NEGOTIATIONS PLATFORM – ALBANIA



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



unicef 
for every child

C1-EU-NPA
CLUSTER ONE EU NEGOTIATIONS PLATFORM – ALBANIA



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

DOKUMENT POLITIKASH

“Efikasiteti i procedurave të azilit dhe sfidat e ndeshura nga ana e institucioneve vendase për trajtimin dhe menaxhimin e migrantëve të parregullt”

Publikuar në dhjetor 2023

Ky publikim i Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) është realizuar në kuadër të projektit C1 – EU – NPA, “Përmirësimi i Debatit mbi Politikat dhe Llogaridhënieën për të Përmbushur të Drejtat Bazike, përmes krijimit të Platformës së Negociatave të Cluster 1 Shqipëri”, zbatuar nga katër organizata shqiptare, Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Institutit për Studimet Politike dhe Instituti Shqiptar i Shkencës, me mbështetjen financiare të Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Tiranë.

Mendimet e shprehura në këtë dokument janë të Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e donatorit dhe organizatave zbatuese.

Përgatitën dokumentin:

Ardita Kolmarku, *Juriste/Menaxhere Projektesh, Komiteti Shqiptar i Helsinkit*

Ardita Matlija, *Asistente Projektesh, Komitetit Shqiptar të Helsinkit*

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: ©Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr. Brigada e VIII-te, Pallati “Tekno Projekt” Shk. 2 Ap. 10, Tirana-Albania

Kutia Postare nr.1752 Tel: 04 2233671

Mob: 0694075732

E-mail: office@ahc.org.al

web site: www.ahc.org.al



PËRMBAJTJA

Përmbledhje Ekzekutive.....	9
Eficienca e procedurave të azilit nën këndvështrimin e Raportit Screening të Komisionit Evropian (Shqipëri, 2022) dhe pasqyrimi i të dhënave mbi aktualitetin	14
1.1 Narrativa e ‘gjakmarrjes’ mes një qëllimi real dhe keqpërdorimit për azil.....	14
1.1.1 Rekomandime mbi trajtimin e narrativës së gjakmarrjes	16
1.2 Hapat e ndërmarrë në përditësimin e kuadrit ligjor vendas	17
1.2.1 Rekomandime mbi mirë-menaxhimin e procesit të përditësimit të kuadrit ligjor vendas.	20
1.3 Trajtimi i azilkërkuesve dhe kapacitetet institucionale vendase për trajtimin dhe menaxhimin e tyre, nën optikën e Komisionit Evropian.....	21
1.3.1 Paraqitja e të dhënave statistikore mbi azilkërkuesit për periudhën Janar-Dhjetor 2022 dhe Janar-Korrik 2023.....	22
1.3.2 Kapacitetet akomoduese dhe infrastrukturore të Qendrës së Pritjes për Azil (Babrru)	24
1.3.3 Rekomandimet e UNICEF mbi vlerësimin e nevojave, vulnerabilitetit dhe eksperiencës së të miturve shqiptarë dhe atyre të huaj në kontekstin e migracionit	25
1.3.3.1 Qasja në shërbime miqësore të azilit dhe mbrojtjes për fëmijët.....	25
1.3.3.2 Forcimi i Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve.....	26
1.3.3.3 Përfshirja e fëmijëve refugjatë dhe migrantë në sistemet kombëtare të mbrojtjes së fëmijëve	26
1.3.3.4 Forcimi i bazës së provave për fëmijët në lëvizje.....	26
1.3.4 Të dhëna statistikore dhe gjetje e rekomandime në kuadër të misionit monitorues të KShH-së në ambientet e Qendrës së Mbyllur Kareç	27
1.4 Përpunimi i të dhënave statistikore dhe cilësore mbi identifikimin dhe trajtimin e imigrantëve të parregullt	29
1.4.1 Të dhëna mbi situatën dhe kapacitet funksionale të Qendrave të Përkohshme të Pritjes.....	33
1.4.2 Rekomandime për përmirësimin e situatës së trajtimit të fenomenit të imigracionit të parregullt	34
1.4.3 ‘Fenomeni i kalimit të paligjshëm të kufirit dhe ndihmës ndaj tij’ si një pasojë e drejtpërdrejtë e migrimit të paligjshëm, nën optikën e praktikës gjyqësore.....	35
1.4.4 Rekomandime nga analiza e vendimmarrjeve gjyqësore:	38

Lista e shkurtimeve

BE	Bashkimi Evropian
CSDG	Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes
DVKM	Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit
FRONTEX	Agjencia Evropiane për Menaxhimin e Bashkëpunimit Operacional në Kufijtë e Jashtëm
INSTAT	Instituti i Statistikave
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
K.P	Kodi Penal
KE	Këshilli i Evropës
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KM	Këshilli i Ministrave
KShH	Komiteti Shqiptar i Helsinkit
LHT	Luftëtarët e Huaj Terroristë
RMSA	Shërbimet Shqiptare për Refugjatë dhe Migrantë
SPAK	Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
SPK	Stacioni i Policisë Kufitare
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

DOKUMENT POLITIKASH

“Efikasiteti i procedurave të azilit dhe sfidat e ndeshura nga ana e institucioneve vendase për trajtimin dhe menaxhimin e migrantëve të parregullt”

Gjeneza e trajtimit të fenomenit nëpërmjet një Dokumenti Politikash

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) në bashkëpunim me disa organizata të shoqërisë civile, nën drejtimin e Qendrës për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG) është duke zbatuar nismën “Përmirësimi i Debatit mbi Politikën dhe Llogaridhënien në përmbushje të kriterëve të Grupit të Parë të Kapitujve Negociues”, mbështetur financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulta në Tiranë.

Natyra komplekse e modeleve të migrimit nga Shqipëria drejt vendeve të ndryshme evropiane, së bashku me ndikimin e liberalizimit të vizave në lëvizjen e lirë të shtetasve shqiptarë brenda zonës Shengen të Bashkimit Evropian në vitin 2010, ka ndikuar në tendencat e vazhdueshme të emigrimit dhe rikthimit e riatdhesimit të mëvonshëm të shtetasve shqiptarë. Ky fenomen që ka prekur jo vetëm vendet evropiane, ka interes publik dhe ka qenë në fokus të institucioneve vendase dhe të huaja, veçanërisht atyre që kanë përgjegjësi në mirë-funksionimin e zbatimit e mekanizmave dhe procedurave ligjore në fushën e migracionit dhe azilit, vetë Bashkimit Evropian si dhe Institucioneve të Drejtave të Njeriut dhe organizatave të shoqërisë civile që janë të angazhuara në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Vitet e fundit, potenciali i zhvillimit të statusit të vendit tonë në nivel rajonal, evropian por edhe më gjerë, së bashku me avancimin dhe forcimin e sektorëve kryesorë ekonomikë e veçanërisht atë të turizmit, ka nxitur nevojën për marrjen e masave drejt përmirësimit të procedurave të përdorura për trajtimin dhe menaxhimin e çështjeve që kanë të bëjnë me emigrantët në vendin tonë, të cilët mund të jenë punëkërkues e studentë, ose emigrantë të parregullt, refugjatë ose azilkërkues.

Raporti Screening i publikuar së fundmi nga Komisioni Evropian për Shqipërinë për vitin 2022 hedh dritë edhe mbi këto çështje të rëndësishme që kërkojnë reflektim të qenësishëm. Raporti thekson nevojën që Shteti Shqiptar të përditësojë Strategjinë Kombëtare për Migracionin dhe Planin shoqëruar të Veprimit për të garantuar zbatimin efektiv dhe të qëndrueshëm të Strategjisë. Gjithashtu, një nga shqetësimet e theksuara në raport është mungesa e një pasqyre gjithëpërfshirëse të rasteve ekzistuese të gjakmarrjes. Ky fenomen që përbën një plagë në shoqërinë shqiptare është përdorur si shkak nga shtetas shqiptarë që kërkojnë azil në vende të ndryshme të Bashkimit Evropian, por jo vetëm.

Qëllimi i këtij dokumenti politikash (*Policy Paper*) konsiston në vlerësimin e nivelit të efikasitetit

të sistemit të azilit, menaxhimit dhe trajtimit të migrantëve të parregullt, duke synuar të përcjellë një panoramë të qartë e të paanshme mbi sfidat e vështirësitë me të cilat përballen një sërë aktorësh si institucionet përgjegjëse vendase në trajtimin dhe menaxhimin e kërkesave të depozituara nga ana e azilkërkuesve, migrantët parregullt që lokalizohen dhe akomodohen në institucionet e mbyllura të vendit tonë, si dhe mbrojtja që i garantohet emigrantëve shqiptarë të cilët shndërrohen në azilkërkues jashtë vendit. Ndër të tjera, ky dokument synon të kontribuojë në zhvillimin e politikave dhe praktikave më efektive dhe humane të migracionit dhe azilit, në mënyrë që të adresojë nevojat e azilkërkuesve, migrantëve të parregullt, si dhe emigrantëve shqiptarë jashtë trojeve.

Të dhënat e analizuar në këtë dokument politikash, të cilat vijnë nga burime të ndryshme e gjithëpërfshirëse informacioni, janë përpunuar nën një metodologji analitike dhe krahasuese. Në përmbushje të saj, KShH përcolli disa kërkesa për informacion, të cilave ju përgjigjen brenda afateve ligjore për të drejtën e informimit, institucionet përgjegjëse si Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Migracionin dhe Azilin pranë Ministrisë së Brendshme, Drejtoria e Politikave për Azilin të Huajt dhe Shtetësinë pranë Ministrisë së Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Në tejkallim të këtij afati u përgjigj Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, pak ditë përpara realizimit të aktivitetit ku prezantohet drafti i këtij dokumenti.

Gjithashtu, në funksion të kësaj analize janë përdorur një sërë burimesh të tjera të vetë organizatës (KShH) dhe burime të tjera alternative, të tilla si të dhënat studimore të KShH-së ndaj praktikës gjyqësore të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm në vendin tonë mbi fenomenin e ‘kalimit të paligjshëm të kufirit dhe ndihmës ndaj tij’, raportet e mekanizmave monitorues e vlerësues vendas dhe ndërkombëtarë, si dhe informacioni i shkëmbyer me Qendrën e Mbyllur për të Huajt pas vizitës monitoruese të ndërmarrë në ambientet e saj nga KShH në muajin mars të vitit 2023.

Gjetjet dhe qëndrimet e reflektuara nëpërmjet këtij Dokumenti Politikash të hartuar nga ekspertët e Komitetit Shqiptar të Helsinkit kanë si qëllim nxitjen e mendimit kritik dhe identifikimin zgjidhjeve të qëndrueshme, nëpërmjet mundësitë të një dialogu konstruktiv midis ekspertëve, përfaqësuesve të institucioneve përgjegjëse, organizatave ndërkombëtare dhe vendase të shoqërisë civile, medias dhe aktorë të tjerë interesi, në fushën azilit dhe migracionit të parregullt.

Ky dokument pasqyron gjithashtu edhe rekomandimet e vetë KShH-së, mbi masat që mund të ndërmerren për përmirësimin e mënyrës së adresimit të sfidave të migrimit të parregullt, vështirësitë e azilkërkuesve, si dhe emigratëve shqiptarë që shndërrohen në azilkërkues jashtë vendit, me synim garantimin e respektimit të dinjitetit njerëzor, trajtimit human dhe të drejtave të këtyre kategorive duke garantuar sigurinë dhe mirëqenien e tyre.

Gjetjet dhe rekomandimet e adresuara nëpërmjet këtij Dokumenti Politikash u bënë objekt diskutimi në një tryezë të përbashkët konsultimi të organizuar më dt. 8 nëntor 2023, me pjesëmarrjen dhe kontributin e çmuar të përfaqësuesve të Ministrisë së Brendshme dhe strukturave të saj të varësisë me kompetenca të drejtpërdrejta në fushën e azilit dhe migracionit, si dhe përfaqësues të Ambasadave të akredituara në vendin tonë, ekspertë e aktivistë të shoqërisë civile. Sugjerimet e rekomandimet e adresuara u vlerësuan kundrejt nevojës për implementimin e tyre në raport me të dhënat e referuara, periudhën konkrete të monitorimit, objektivat e synimet e vlerësimit të masave të marra për zbatueshmërinë e rekomandimeve të lëna nga Raporti Screening.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në një peizazh global që ndryshon me shpejtësi, ku modelet e migracionit janë gjithnjë më komplekse, përpjekjet e Shqipërisë për të menaxhuar fluksin e migrantëve dhe refugjatëve janë të dukshme. Pavarësisht hapave të ndërmarrë nga institucionet përgjegjëse në nivel epror dhe vendor për menaxhimin e migracionit dhe azilit brenda territorit kombëtar vendas, lind nevoja për perceptimin e këtyre veprimeve në një formë të qëndrueshme e në bashkëpunim të ngushtë me fqinjët rajonalë dhe aktorët ndërkombëtarë.

Aktualisht vendi ynë është afektuar nga fenomeni “*brain drain*” apo emigrimi i individëve me aftësi të larta dhe të arsimuar nga Shqipëria, është një shqetësim i rëndësishëm për vendin. Ky fenomen jo vetëm që rezulton në humbje të talentit dhe ekspertizës, por mund të ketë edhe efekte negative në ekonomi dhe zhvillim social. Shumë shqiptarë me diploma të avancuara dhe aftësi profesionale kërkojnë mundësi jashtë vendit, shpesh për shkak të mungesës së punëve të paguara mirë dhe perspektivës për karrierë të qëndrueshme në atdheun e tyre. Sipas të dhënave të INSTAT, periudha nga viti 2011 deri në vitin 2019 ka pasur një model relativisht të balancuar imigrimi, me 120,754 individë që kanë migruar në Itali, 92,159 në Greqi dhe 40,468 në Gjermani, por një numër i konsiderueshëm nuk janë kthyer deri në vitin 2019. Për më tepër, këto tendenca të emigrimit po kontribuojnë për plakjen e popullsisë së Shqipërisë.

Paralelisht me emigrimin e shqiptarëve, përballen me sfida kapacitetet e pamjaftueshme të autoriteteve përgjegjëse vendase për kufirin, azilin dhe migracionin, sidomos në rastet e fluksit të migrantëve e azilkërkuesve, me fokus të shtuar migrantët e parregullt. Në tërësi, vlerësojmë se duke i dhënë përparësi zgjerimit të kapaciteteve të qendrave dhe autoriteteve pritëse, promovimit të integritetit të komunitetit dhe nxitjes së bashkëpunimit ndërkombëtar, Shqipëria mund të forcojë menaxhimin efektiv të rasteve komplekse që lidhen kryesisht me migrimin e parregullt. Ky dokument eksploron hapat e ndërmarra nga vendi ynë dhe përshkruan në një qasje gjithëpërfshirëse masat që mund të ndërmerren për përmirësimin e mënyrës së adresimit të sfidave të migrimit të parregullt, vështirësitë e azilkërkuesve, si dhe emigrantëve shqiptarë që shndërrohen në azilkërkues jashtë vendit, me synim garantimin e respektimit të të drejtave dhe dinjitetit të këtyre kategorive duke garantuar sigurinë dhe mirëqenien e tyre.

Gjithashtu, sfidues në kuadër të procesit të integritetit evropian mbetet përmirësimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor vendas për migracionin duke synuar përafrim më të plotë me *acquis* të BE-së dhe adresimi nën një qasje gjithëpërfshirëse dhe të shpejtë të rekomandimeve të lëna në raportin Screening të Komisionit Evropian. Nëpërmjet përditësimit, nën një klimë konsultuese gjithëpërfshirëse dhe joformale, të Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planit të Veprimit në zbatim të saj, forcimit të Planit të Emergjencës/Kontigjencës dhe prioritizimit të marrëveshjeve të ripranimit me vendet e origjinës të azilkërkuesve, Shqipëria mund të krijojë një kuadër të fortë dhe koherent që jo vetëm mbron interesat e saj kombëtare, por gjithashtu promovon stabilitetin, sigurinë dhe bashkëpunimin rajonal e ndërkombëtar në kontekstin e menaxhimit të kufijve dhe migracionit.

Në ligjin nr. 79/2021 “Për të Huajt” dhe Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.174, datë 12.09.2022 “Mbi procedurat e trajtimit të të huajve me qëndrim të parregullt në territorin e Repub-

likës së Shqipërisë”, është parashikuar klasifikimi i imigrantëve në disa kategori si: a) subjekt i refuzimit të hyrjes b) kërkues i mbrojtjes ndërkombëtare c) viktimë e mundshme e trafikimit d) imigrant i parregullt e) i mitur i pashoqëruar. Të dhënat statistikore dhe cilësore të vëna në dispozicion nga institucionet përgjegjëse vendase reflektojnë se trajtimi i të huajve në vendin tonë, realizohet duke mbajtur në konsideratë këtë kategorizim.

Për periudhën 9 mujore të vitit 2023 (Janar-Shtator), rezulton t’i jenë nënshtruar procesit të verifikimit minimal kufitar 117,789 shtetas të huaj. Nga të dhënat zyrtare të vëna në dispozicion rezulton se gjatë vitit 2022, janë ndëshkuar me gjobë për shkelje të afatit të qëndrimit në territor 526 shtetas, ndërkohë që në 6 mujorin e vitit 2023 rezultojnë të gjobitur 220 shtetas të huaj. Përdorimi i dokumenteve të falsifikuara me qëllim kalimin e paligjshëm të territorit vendas shtetëror, është konstatuar si një praktikë jo e munguar, me një reduktim të lehtë në vitin 2023. Më konkretisht në vitin 2022, janë ndaluar 137 shtetas të huaj të ndodhur në këtë situatë faktike, ndërkohë që 73 shtetas janë ndaluar për periudhën e parë 6 mujore të vitit 2023. Mos plotësimi i kushteve për të hyrë në vendin tonë, të parashikuara në nenet 6 dhe 9 të ligjit nr. 79/2021 ‘Për të huajt’, ka përbërë shkak për refuzimin në hyrje të 2101 shtetasve të huaj gjatë vitit 2022, ndërkohë që në 6 mujorin e vitit 2023 janë refuzuar në hyrje 643 shtetas të huaj. Vlen të mbahet në konsideratë se masat refuzuese duhet të shoqërohen nga vendimmarrjet e argumentuara dhe transparente, për të parandaluar keqkuptimet dhe keqinterpretimet e ligjit.

Informacionet e vëna në dispozicion nga Autoriteti Përgjegjës për Kufirin dhe Migracionin dhe Qendra e Pritjes për Azil në Babrru, reflektojnë se matësi i kohëzgjatjes minimale të qëndrimit të azilkërkuesve në këtë institucion është tregues i një sistemi të përshpejtuar të përpunimit të të dhënave, në përputhje me urgjencën që shpesh lidhet me nevojat e azilkërkuesve për siguri dhe stabilitet. Autoritetet e duhen mesatarisht një kohëzgjatje prej 10-15 ditësh për realizimin e proceseve thelbësore administrative, duke përfshirë vlerësimet fillestare, ekzaminimet shëndetësore dhe informimet procedurale. Këto afate mundësojnë një vlerësim më të plotë të nevojave të azilkërkuesve dhe thjeshtojnë ofrimin e shërbimeve të nevojshme gjatë qëndrimit të tyre kalimtar brenda Qendrës së Pritjes për Azil. Ndërkohë, afatet maksimale të akomodimit të azilkërkuesve variojnë nga 8 deri në 10 muaj, çka në vlerësimin e KShH-së përbën një kohëzgjatje të tejkujtur, e cila hedh dritë mbi sfidat që lidhen me rastet komplekse, ndërlikimet procedurale dhe pengesat e mundshme në procesin e shqyrtimit administrativ dhe atij gjyqësor të vendimmarrjeve të dhëna mbi kërkesën për azil. Rrjedhimisht, afatet maksimale kohore diktojnë domosdoshmërinë për përmirësime sistematike në efikasitetin e përpunimit dhe zgjidhjen e shpejtë të rasteve për të shmangur qëndrimet e zgjatura që mund të përkeqësojnë gjendjen psikologjike dhe sfidat e integritetit për këtë kategori azilkërkuesish. Gjithashtu, duke mbajtur në konsideratë kapacitetin pritës prej 220 personash, vlerësojmë se administrata aktuale funksionale prej 18 punonjësish, nuk mund të konsiderohet nën një proporcionalitet të arsyeshëm për të garantuar ofrimin e shërbimeve adekuate në rastet e flukseve të të akomoduarve.

Në raport me vitin 2022, ku numri i individëve që kanë depozituar kërkesa për mbrojtje ndërkombëtare (azil) në Republikën e Shqipërisë ishte 125, në 7 mujorin (Janar-Korrik) të vitit 2023 janë regjistruar 123 kërkesa. Kjo rritje e konsiderueshme i përket numrit të azilkërkuesve me origjinë nga Afganistani, Iraku, Irani, Somalia dhe Jemeni. Në rast se periudha 5 mujore vijuese deri në fund të vitit 2023, do të reflektojë rritje progresive të numrit të kërkesave, atëherë ky tregues kërkon vigjilencë

të shtuar të autoriteteve dhe analiza sistematike gjithëpërfshirëse, pasi reflekton një grup kompleks faktorësh rajonalë dhe globalë që kanë çuar në rritjen e pasigurisë dhe paqëndrueshmërisë në këto rajone përkatëse, duke përfshirë këtu faktorët gjeopolitikë, socio-ekonomikë dhe humanitar. Kjo qasje do të ndihmonte më mirë autoritetet të planifikojnë dhe akomodojnë paraprakisht nevojat dhe sfidat e shumanshme që lidhen me fluksin e shtuar të migrantëve të huaj dhe azilkërkuesve, veçanërisht nga rajone të “pushtuara” nga konflikte, trazira politike dhe shkelje të përhapura të të drejtave të njeriut.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga ana e autoriteteve përgjegjëse të azilit dhe migracionit mbi numrin e azilkërkuesve, tërheq vëmendjen numri i munguar i vendimmarrjeve refuzuese të dhëna ndaj kërkesave të adresuara nga shtetasit e huaj për mbrojtje ndërkombëtare për periudhën 2022-2023, ndërkohë që kanë dominuar shtetasit e huaj që kanë tërhequr në mënyrë të vullnetshme kërkesën e tyre për mbrojtje ndërkombëtare. Nga ana e autoriteteve vendase nuk ofrohet informacion i detajuar lidhur me analizën e shkaqeve dhe faktorëve që i kanë shtyrë të huajt për të hequr dorë, ndërkohë që mbetet i munguar edhe informacioni mbi vendndodhjen e këtyre shtetasve. Këto të dhëna të sipërcit-uara nënvizojnë nevojën për më shumë llogaridhënie, transparencë dhe respektim të protokolleve të vendosura nga ana e institucioneve kontrolluese në nivel epror, siç është Komisioni Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët dhe Ministria e Brendshme. Është e domosdoshme që politikat përmirësuese që do të ndërmerren të adresohen në mënyrë strategjike për të siguruar shqyrtimin e drejtë dhe efikas të kërkesave për azil e procedurës që ndiqet edhe në rastet e refuzimit të tyre apo heqjes dorë në mënyrë të vullnetshme, në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i përpjekjeve ndërmjet institucioneve kyçe si Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimin Kombëtar të Punësimit dhe Inspektoriatit Shtetëror të Punës është i rëndësishëm për rritjen e mirëqenies dhe standardeve të trajtimit të azilkërkuesve, si dhe lehtësimin e riintegrit të tyre në shoqëri. Duke riorganizuar përpjekjet dhe burimet, Qeveria jo vetëm që mund të kontribuojë në avancimin socio-ekonomik të azilkërkuesve, por edhe të sigurojë integrimin e tyre të qëndrueshëm në shoqërinë shqiptare.

Vitet e fundit, të dhënat nga burime të besueshme kanë treguar vazhdimisht se përkundrajt të rriturve, të rinjtë e moshës 15 deri në 29 vjeç përbëjnë grupin e dytë më të madh të migrantëve ndërkombëtarë. Kjo prirje ka vazhduar që nga viti 1990, duke nxjerrë në pah nevojën urgjente për një qasje të fokusuar në adresimin e nevojave, dobësive dhe përvojave të fëmijëve në kontekstin e migracionit, shqiptarë dhe joshqiptarë. Rekomandimet e UNICEF-it përshkruajnë një narrativë që nënvizon aspektet kritike të kësaj përpjekjeje. Duhet theksuar se çdo veprim i ndërmarrë në lidhje me fëmijët në lëvizje duhet të ketë prioritet interesin e tyre më të mirë dhe mosdiskriminimin, duke vendosur mirëqenien e tyre mbi statusin e tyre të migrimit. Qasja në azil për fëmijët, qofshin ata të ardhur me familjet e tyre apo të pashoqëruar, konsiderohet thelbësore dhe duhet mbrojtur.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 dhe Janar-Korrik 2023, rezulton se nuk ka pasur raste të shtetasve që kanë përfituar statusin e refugjatit/mbrojtjes plotësuese të cilët janë larguar nga Shqipëria me dëshirën e tyre, por gjatë periudhës së sipërcituar përpara shqyrtimit nëpërmjet procedurës së kërkesës së tyre për azil, rreth 3,137 shtetas afganë kanë tërhequr kërkesën e tyre për mbrojtje të përkohshme dhe janë larguar me dëshirë nga vendi ynë. Këto të dhëna statistikore krijojnë premisa për kategorizimin e vendit tonë si një vend i migracionit tranzit, i cili nuk është destinacion për këta shtetas.

Ndaj të huajt subjekt i një procedure dëbimi, kur janë ekzekutuar të gjitha masat e mundshme alternative, ose në rast se vlerësohet nga ana e autoriteteve përgjegjëse se këto masa nuk mund të zbatohen ndaj të huajt, qoftë ai edhe i ripranuar, aplikohet masa e fundit administrative e ndalimit të tij në ambientet e Qendrës së Mbyllur të vendosur në Kareç. Të dhënat e vëna në dispozicion nga ana e Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit reflektojnë se në raport ndërmjet vitit 2022 dhe 2021, kemi një diferencë të lehtë të vërejtur në raport me transferimet e shtetasve të huaj për në këtë Qendër, pas kapjes së tyre në kufi/territor vendas. Më konkretisht, në vitin 2021 janë identifikuar 69 shtetas të huaj, ndërsa në vitin 2022 numërohen 65 shtetas. Një rritje prej 11 shtetas më shumë është vërejtur edhe gjatë periudhës 9 mujore të vitit 2023 (34 shtetas të huaj), në raport me numrin e shtetasve të huaj në të njëjtën periudhë kohore 9 mujore që i përket vitit 2022 (23 shtetas të huaj).

Misioni monitorues në terren i ndërmarrë nga vëzhgues të KShH-së, në muajin Mars 2023, evidentoj kushte të papërshtatshme infrastrukturore në ambientet e Qendrës së Mbyllur për të Huajt (Kareç), të cilat nuk sigurojnë standardet minimum të trajtimit dinjitoz. Për adresimin e situatës konkrete kërkohen përmirësime në drejtim të marrjes së masave për garantimin e përmbushjes së parimeve themelbësore të respektit, dinjitetit dhe humanizmit ndaj shtetasve të huaj të parregullt të ndaluar e të vendosur në këtë institucion. Përpjekjet bashkëpunuese të autoriteteve vendase që punojnë në partneritet me organizatat ndërkombëtare (siç është IOM) reflektojnë hapa të rëndësishëm të ndërmarrë me synim korrigjimin e mangësive dhe rivendosjen e dinjitetit dhe të drejtave të kësaj kategorie.

Nga informacioni i përcjellë nga ana e Departamentit për Kufirin dhe Migracionin rezulton se gjatë periudhës 9 mujore Janar-Shtator 2023, në vendin tonë janë kapur gjithsej 5,804 shtetas të huaj imigrantë të parregullt, ku 4,139 kanë qenë autorë për herë të parë dhe 1,665 përsëritës. Kjo shënon një ulje të ndjeshme prej 3,071 rastesh, që paraqet një rënie prej -34% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë (2022). Mendohet se ndikim në rënien e kurbës kanë pasur kontrollat e shtuara në kufirin e gjelbër në zonën operationale Kakavijë/Kapshticë, ku dhe janë dislokuar forcat e FRONTEX-it. Gjatë 9 mujorit të vitit 2022, u kapën 8,875 imigrantë të parregullt, ku 6,059 ishin shkelës për herë të parë dhe 2,816 përsëritës. Në total në vitin 2022, në vendin tonë janë lokalizuar dhe kapur 11,216 imigrantë të parregullt (8,335 për herë të parë dhe 3,881 përsëritës). Viti 2022 konsiderohet një periudhë që ka numëruar një shifër më të ulët të numrit të imigrantëve të parregullt, krahasuar me vitin 2021, gjatë të cilit rezultojnë të jenë lokalizuar dhe kapur në vendin tonë 18,496 ose rreth 66% shtetas të huaj imigrantë të parregullt (10,062 për herë të parë dhe 8,434 prej tyre përsëritës). Vlerësojmë se përpos rëndësisë që paraqet analiza e të dhënave statistikore mbi numrin e imigrantëve të parregullt për herë të parë, numri i shtetasve recidivistë në një raport rreth 50% ndërmjet dy viteve, vlen të studiohet në një formë empirike dhe të thelluar, në mënyrë që të përkthehet në masa imediate logjistike dhe ligjore që duhet të ndërmerren nga autoritetet vendase për të reduktuar efektet e këtij fenomeni. Kryesisht imigrantët e parregullt të kapur në territorin e Republikës së Shqipërisë rezulton të jenë të ardhur nga Bangladeshi, Afganistani, Algjeria, Eritrea, Siria, Somalia dhe Nepali. Mbi 95% e tyre janë të gjinisë mashkullore dhe të moshave nga 20-50 vjeç.

Për sa i përket identifikimit dhe kapjes së shtetasve të vendeve të treta që tentojnë të kalojnë tranzit nga Shqipëria në rrugë drejt vendeve të BE-së, të dhënat zyrtare reflektojnë se ka pasur një rënie prej 6280 individësh, ose një ulje prej 33,95% krahasuar me vitin 2021, e vërejtur gjatë vitit 2022. Ndërkohë që momentalisht evidentojen të dhëna të munguara për 9 mujorin e vitit 2023.

Format e parregullta apo të paligjshme që përdoren nga ana e migrantëve për të hyrë në territorin shqiptar, siç është fenomeni i kontrabandimit të migrantëve dënohet penalisht sipas Kodit tonë Penal dhe përbën një kërcënim serioz për sigurinë e kufijve të Republikës së Shqipërisë, por edhe një rrezik konkret ndaj respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut. Me këtë fenomen po përballen të gjitha vendet rajonale, shtetet evropiane dhe më gjerë, pavarësisht demokratizimit të politikave penale parandaluese dhe ndëshkimore që qeveritë kanë ndërmarrë. Nëpërmjet të dhënave studimore të analizuara nga kampioni i 106 vendimmarrjeve të 5 Gjykatave të Rretheve Gjyqësore, rezulton se në 86 raste, rrethanat faktike janë kualifikuar si kalim i paligjshëm i kufirit i parashikuar në nenin 297 të Kodit Penal, ndërkohë që në 5 raste me veprimet e tyre të pandehurit rezulton se kanë përmbushur edhe elementë të veprave penale “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave” (parashikuar nga neni 189/1 K.Penal) ose në konkurrim me veprën penale të ‘Ndhmës për kalim të paligjshëm të kufijve’ (parashikuar nga neni 298 K. Penal). Ndërkohë në 19 raste, Gjykata ka kualifikuar veprimet e ndërmarra nga të gjykuarit si “Ndhmë për kalim të paligjshëm të kufirit” në formën klasike, si dhe në rrethana cilësuese. Gjykatat, vendimmarrjet e të cilave janë marrë në analizë rezulton se nuk kanë dhënë dënime penale për të huajt që janë ndihmuar për të kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme. Madje ata përmenden vetëm në analizën e rrethanave të faktit, dhe i gjithë procesi është zhvilluar në ngarkim të personit (të pandehurit) të akuzuar se ka bërë transportin e tyre, për veprën penale “Ndhma për kalim të paligjshëm të kufijve” parashikuar nga neni 298 i K.P. Në përgjithësi, kjo politikë e ndjekur nga Gjykatat objekt studimi në parim duket e drejtë, pasi emigrantët e parregullt duhet të trajtohen në bazë të procedurave administrative të parashikuara në legjislacionin specifik për të huajt dhe nuk duhet të jenë subjekt i ndjekjes penale të legjislacionit penal material.

Përpunimi i të dhënave të reflektuara në vendimmarrje ka ofruar informacion sporadik rreth përfitimit financiar të kontrabanduesve, që varion nga 100-500 Euro. Nuk kanë munguar rastet kur ndihma për kalimin e paligjshëm të kufirit shtetëror është dhënë nga ana e grupeve të mirë-strukturuar, e si rrjedhojë vlera e akorduar deri në mbërritjen në destinacionin final ka qenë ajo deri në 9000 Euro. KShH vëren se format e sofistikuara të bashkëpunimit midis rrjeteve kriminale në rajon për kontrabandimin, nuk hetohen ose hetohen shumë pak. Ashtu sikurse praktika gjyqësore e studiuar ka elaboruar, edhe për autoritetet përgjegjëse për kufirin dhe migracionin është e qartë se drejtimet kryesore të hyrjes në vendin tonë të shtetasve të huaj imigrantë të parregullt vijnë të evidentohen kryesisht në kufirin me Greqinë. Të dhënat statistikore raportojnë se sa i takon rrugës/drejttimeve kryesore që ato ndërmarrin, vijnë të mbeten si kryesore rajoni i Korçës, kryesisht në zonën e Kapshticës; rajoni i Gjirokastrës, kryesisht në zonën e Kakavijës dhe rajoni i Sarandës, kryesisht në zonën e Konispolit (drejtim Qafë Botë). Më konkretisht, fluksi i migracionit të parregullt është i përqendruar kryesisht në vendkalimet rrugore të qarqeve Vlorë dhe Korçë, me rreth 75% të emigrantëve të kapur të regjistruar (43% në Vlorë dhe 35% në Korçë). Përdorimi i kufirit të gjelbër gjithashtu lejon kalim relativisht të lehtë, ndërkohë që kryesisht infrastruktura më e mirë rrugore në afërsi të pikës së kalimit Kakavijë e Kapshticë, synohet si një itinerar i përshtatshëm transporti drejt Malit të Zi dhe Kosovës, me destinacion vendet e BE-së e kryesisht Gjermaninë.

Të dhënat e studiuar nënvizojnë nevojën kritike për një qasje më humane, riintegruese dhe rehabilituese për adresimin e sfidave të shumanshme të paraqitura nga fenomeni i migrimin të paligjshëm. Me një theks të shtuar në identifikimin e faktorëve kyç që nxisin dhe shtyjnë shtetasit shqiptarë që migrojnë në mënyrë të paligjshme në mënyrë të përsëritur, është e rekomandueshme që organet e

drejtësisë penale të reflektojnë në praktikën hetimore dhe gjyqësore, një qasje të unifikuar humane.

Nuk kanë munguar rastet kur shtetasit shqiptarë janë pozicionuar si azilkërkues në vende të ndryshme evropiane dhe jo-evropiane. Eksperienca e elaboruar edhe në një sërë raportesh studimore, ka treguar se përgjatë viteve ka patur tendenca që fenomeni i gjakmarrjes të keqpërdoret nga shtetas shqiptarë në kontekstin e procedurave të azilit. Ky keqpërdorim paraqet një sfidë të rëndësishme si për autoritetet e azilit në vendet e BE-së, ashtu edhe për azilkërkuesit e vërtetë. Sipas të dhënave të përcjella nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, nga muaji nëntor i vitit 2022 rezulton se në Republikën e Shqipërisë janë të prekura nga fenomeni i gjakmarrjes 1,187 familje dhe janë larguar jashtë shtetit 95 familje, ndërkohë që 67 familje regjistrohen si të ngujuara. Nga ana tjetër, rezulton se strukturat përgjegjëse të Policisë në nivel vendor dhe qendror po punojnë për ngritjen e një sistemi databazë për evidentimin e të dhënave të kategorizuara, e cila do i shërbejë institucioneve vendase dhe atyre ndërkombëtare. Duke zbatuar një qasje gjithëpërfshirëse që përfshin ndjeshmërinë kulturore dhe bashkëpunimin me autoritetet vendase, BE-ja dhe vendet e tjera pritëse mund të kenë një panoramë më objektive për vërtetësinë e këtyre shkaqeve duke ruajtur integritetin e sistemeve të tyre të azilit. Masa të tilla janë të rëndësishme, për të siguruar që azili u jepet atyre që vërtet përballen me persekutim dhe kërcënime për jetën e tyre, në përputhje me detyrimet humanitare ndërkombëtare.

Eficienca e procedurave të azilit nën këndvështrimin e Raportit Screening të Komisionit Evropian (Shqipëri, 2022) dhe pasqyrimi i të dhënave mbi aktualitetin

1.1. Narrativa e ‘gjakmarrjes’ mes një qëllimi real dhe keqpërdorimit për azil

Fenomeni i gjakmarrjes ka qenë prej kohësh një çështje shqetësuese në shoqërinë shqiptare, e ngulitur thellë brenda normave kulturore dhe tradicionale. Ky fenomen ka gjetur një dimension të ri në kuadrin e procedurave të azilit në Bashkimin Evropian (BE) dhe vende të tjera jashtë saj. Nëpërmjet të dhënave të reflektuara në këtë seksion synohet që të ndahet në mënyrë objektive informacioni i huazuar nga burimet zyrtare të informacionit dhe të analizohet sadopak vërtetësia e pretendimeve për keqpërdorim të gjakmarrjes nga ana e shtetasve shqiptarë në procesin e azilit, jashtë territorit të vendit tonë.

Në vendin tonë, ky fenomen ka qenë historikisht pjesë e strukturës shoqërore të zonave kryesisht veriore të vendit, duke shërbyer shpesh si mjet për zgjidhjen e konflikteve mes familjeve apo komuniteteve. Të rrenjosura në konceptin e nderit dhe hakmarrjes, përjetësimi i këtyre grindjeve ka rezultuar në një cikël dhune, duke marrë jetë të shumta dhe duke shkaktuar përçarje shoqërore.

Pretendohet se disa shtetas shqiptarë që kërkojnë azil në BE dhe vende të tjera kanë shfrytëzuar narrativën e gjakmarrjes si një mjet për të forcuar kërkesat e tyre për azil. Në fakt, për një precedent të tillë, ngriti alarmin prej vitit 2012 organizata vendase Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Në raportin vjetor mbi veprimtarinë e tij, KShH solli në vëmendjen e publikut dhe shfaqti shqetësim se “më shumë se 11 vrasje makabre” ishin të regjistruara në vendin tonë nën petkun e faktorit ‘gjakmarrje’⁽¹⁾. Ndër vite⁽²⁾, fenomeni shqetësues i ngujimit të familjeve (mes të cilëve edhe të mitur) ka nxitur reagime publike të KShH-së⁽³⁾, ndërkohë që thirrje publike i janë adresuar Qeverisë dhe organeve shtetërore përkatëse për vlerësimin me seriozitet të këtij shqetësimi, pasi masa konkrete nevojiten për zgjidhjen efektive të këtij fenomeni.⁽⁴⁾

Gjithashtu, në vitin 2015, institucioni i Avokatit të Popullit në raportin e tij të veçantë ndër të tjera

⁽¹⁾ KShH referoi këtë gjetje në publikimin e Gazetës Shqip 13 Shtator 2012, sipas të cilit “vetëm në Dukagjin e Pukë 11 të vrarë për gjakmarrje brenda këtij viti”.

KShH, “Raport mbi situatën e respektimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri për vitin 2012”, publikuar më Janar 2023. Akses online: chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://ahc.org.al/ep-content/uploads/2017/04/Raport_te_te_drejtave_te_njeriut_Klinika_ligjore_19_dhjetor-2012_shqip.pdf

⁽²⁾ KShH, Njoftim për shtyp “Gjakmarrja – fenomeni i një të kaluarë të dhimbshme që vijon të jetë aktual”, postuar më 27 Janar 2022. Akses online: https://www.facebook.com/KomitetiShqiptarIHelsinkit/photos/a.330295387093998/4489802447809917/?type=3&locale=hi_IN

⁽³⁾ KShH, Njoftim për shtyp, publikuar më 14 Nëntor 2017. Akses online: <https://www.cna.al/2017/11/14/gjakmarrja-denoht-rende-por-ngujimi-vazhdon>

⁽⁴⁾ <https://telegraf.al/aktualitet/komiteti-shqiptar-i-helsinkit-reagon-gjakmarrja-denoht-rende-por-ngujimi-vazhdon/>

konstatonte “nga të dhënat e siguruar nga autoritetet e vendeve të huaja në bashkëpunim me strukturat ligjzbatuese shqiptare rezulton se shumë nga azilkërkuesit shqiptarë kanë mashtruar me motivin e gjakmarrjes duke siguruar e paraqitur dokumenta të fallsifikuara sikur janë pjesëtare të familjeve që janë në gjakmarrje dhe se u rrezikohet jeta në Shqipëri”.⁽⁵⁾

Edhe pse padyshim që ekzistojnë raste të vërteta të persekutimit dhe kërcënimeve me jetë për shkak të gjakmarrjes, keqpërdorimi i kësaj praktike kulturore gjatë procesit të depozitimit dhe shqyrtimit të kërkesës për azil përbën sfidë për integritetin e vetë sistemit të azilit. Ky shfrytëzim jo vetëm që minon besueshmërinë e azilkërkuesve legjitimë, por gjithashtu krijon vështirësi dhe ngarkesë mbi burimet njerëzore dhe kapacitetin e sistemeve të azilit të vendeve pritëse.

Raportimet e organizmave vendas nxitën Kuvendin e Republikës së Shqipërisë në hartimin e një Rezolutive për Parandalimin e Fenomenit të Gjakmarrjes në Shqipëri.⁽⁶⁾ Këshillit Koordinues në Luftën kundër Gjakmarrjes⁽⁷⁾ iu besua kompetenca e hartimit të një Strategjie Kombëtare. Në faqet zyrtare të institucioneve vendase, ekspertët e KShH-së nuk kanë mundur të identifikojnë asnjë strategji të finalizuar për këtë qëllim dhe nuk ka të dhëna lehtësisht të aksesueshme elektronikisht mbi aktet nënligjore që janë parashikuar të miratohen nga ana e Këshillit të Ministrave, në përmbushje të neneve 4,5 dhe 6 të ligjit nr. 9389/2005.

Parë nën optikën e Komisionit Evropian dhe rastet e precedentët e bërë mediatikë në vendin tonë, por jo vetëm, rastet e gjakmarrjes kanë pësuar një rënie. “Megjithatë, mungon një pasqyrë e saktë e rasteve ekzistuese dhe gjakmarrja ende përmendet shpesh nga qytetarët shqiptarë që paraqesin aplikime për azil në BE. Vendi duhet të sigurojë që çështja e gjakmarrjes të trajtohet si shkelje e vlerave dhe parimeve themelore dhe të trajtohet si çështje kriminale. Monitorimi sistematik i rasteve ekzistuese duhet të jetë i disponueshëm për të vlerësuar situatën në mënyrë periodike.”⁽⁸⁾

Nga informacioni paraprak zyrtar i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit⁽⁹⁾ rezulton se sipas të dhënave të administruara nga muaji Nëntor 2022 në Republikën e Shqipërisë janë prekur nga fenomeni i gjakmarrjes 1187 familje. Janë larguar jashtë shtetit 95 familje, ndërkohë që 67 familje regjistrohen si të ngujuara. Rezulton se aktualisht Policia e Shtetit në vendin tonë nuk ka referuar pranë organit procedues Prokurorisë, asnjë procedim penal për fenomenin e gjakmarrjes. Bëhet e ditur se Drejtoria për Hetimin e Krimeve të Rënda në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit është në procesin e mbledhjes së të dhënave lidhur me fenomenin e gjakmar-

⁽⁵⁾ Avokati i Popullit, Raport i Veçantë “Mbi fenomenin e gjakmarrjes në Shqipëri”, publikuar në Dhjetor 2015, fq. 27. Akses online: <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgclefindmkaj/https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/RAPORT%20I%20VE%20C%3%87ANT%20C%3%8B%20nr.%202020per%20gjakmarrjen.pdf>

⁽⁶⁾ Rezolutë, publikuar në FZ nr. 38, datë 18/03/2015. Akses online: <https://qbz.gov.al/eli/rezolute/2015/03/05/38-1/3fd74c03-ecea-42fd-ab72-cea6d6feb97c>

⁽⁷⁾ Ngritur nëpërmjet ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes”

⁽⁸⁾ Komisioni Evropian, Raporti Screening për Shqipërinë, publikuar në 24 Korrik 2023, fq. 53. Akses online: chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgclefindmkaj/https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-07/AL%20Cluster_1%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf

⁽⁹⁾ Shkresë nr. 8245/1 prot., dt. 04.10.2023, “Kthim përgjigje”, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

rjes, informacion kërkuar Drejtorive Vendore të Policisë në qarqe. Të dhënat e grumbulluara pritet të pasqyrohen në një databazë të dedikuar mbi këtë fenomen, e cila do të garantojë gjenerimin e të dhënave të kategorizuara për familjet në gjakmarrje, anëtarët e familjeve, moshën, të miturit, familjet e ngujuara, familjet e larguara etj.

Pavarësisht se nga ana e autoritetit përgjegjës të Policisë së Shtetit është shmangur dhënia e përgjigjes mbi vështirësitë që ndeshin strukturat e Policisë në ndjekjen dhe referimin e rasteve të lidhura me fenomenin e gjakmarrjes në vendin tonë, vlerësohet se të dhënat e pjeshme të referuara sa më lart nxisin nevojën për marrjen e masave urgjente dhe shtimin e hapave për identifikimin e plotë të të dhënave, si dhe regjistrimin e përpunimin e tyre në formë të kategorizuar. Mungesa e këtyre të dhënave të detajuara, gjithëpërfshirëse dhe objektive, rrit vështirësitë dhe peshën mbi autoritetet përgjegjëse të azilit dhe migracionit të vendeve evropiane dhe atyre jo-evropiane pritëse, të cilat synohen nga ana e azilkërkuesve shqiptarë. Nëse këto të dhëna do të ishin të grumbulluara plotësisht dhe të lehtësisht të përpunueshme, do të ndihmonin në dallimin e rasteve autentike të persekutimit të lidhur me gjakmarrjen dhe tregimeve të sajura që synojnë sigurimin e statusit të azilit. Mungesa e provave konkrete dhe ndërlikimet e të kuptuarit të kontekstit kulturor vendas që shoqëron gjakmarrjen paraqesin sfida thelbësore në vlerësimin e saktë të mbështetjes e pranueshmërisë së këtyre pretendimeve.

Për shkak të mungesës së unifikimit të praktikave, nisur nga ndryshimet e sistemeve ligjore ndërmjet vendeve evropiane dhe atyre jo-evropiane, ka tërhequr vëmendjen tonë vendimmarrja e vitit 2012 e Gjykatës së Lartë të Mbretërisë së Bashkuar, e cila gjatë shqyrtimit të rastit, pas vlerësimit të provave ka pranuar se shteti shqiptar nuk ofronte mbrojtjen e duhur për ata që janë në gjakmarrje aktive, veçanërisht në veri të vendit.⁽¹⁰⁾ Të dhënat e pasqyruara në këtë Dokument Politikash nuk kanë si qëllim shprehjen e këndvështrimeve mbi retorikën e cila ka shoqëruar vendimmarrjet e autoriteteve të Mbretërisë së Bashkuar për kufizimet legjislative për të drejtat për azil, por në vlerësimin tonë të dhënat e autoriteteve ligjzbatuese shqiptare mund t'i shërbejnë thelbësisht krijimit të praktikave e të shërbejnë si arsye për depozitim të ankimeve administrative e gjyqësore nga ana e azilkërkuesve të cilëve iu refuzohet e drejta e mbrojtjes ndërkombëtare. Në ofrimin e këtij vlerësimi, mbajmë në konsideratë, mungesën e një kuadri të standardizuar për vlerësimin e legjitimitetit të kërkesave për azil lidhur me gjakmarrjen, një vështirësi e cila e ndërlikon më tej procesin e vendimmarrjes për autoritetet e azilit të vendeve evropiane dhe atyre jo-evropiane.

1.1.1. Rekomandime mbi trajtimin e narrativës së gjakmarrjes

- Sa kohë që vendi ynë ndodhet në procesin e ngritjes së sistemit elektronik të të dhënave për fenomenin e gjakmarrjes, nisur nga artikujt deklarativë mediatikë të studiuesve ligjorë vendas dhe të huaj, që ofrojnë ekspertizë në çështjet e azilit dhe migracionit, sugjerohet përfshirja e oficerëve të linjës së parë (të pritjes) së autoriteteve evropiane dhe jo-evropiane të azilit dhe migracionit, në trajnime gjithëpërfshirëse mbi ndërlikimet kulturore të gjakmarrjes në Shqipëri

⁽¹⁰⁾ <https://dosja.al/aktualitet/analiza-e-the-guardian-femijet-shqiptare-vijne-ne-britani-per-siguri--i277813>

për të lehtësuar një kuptim më të mirë të kontekstit brenda të cilit lindin këto pretendime nga ana e shtetasve shqiptarë që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare në vendet pritëse.

- Sugjerohet përcaktimi i udhëzimeve dhe standardeve operacionale të qarta, bazuar në parimet konventore që prekin çështjet e azilit dhe migracionit (por edhe ato kundër trafikimit të genieve njerëzore), për vërtetimin e pretendimeve në lidhje me gjakmarrjen. Marrja e masave konkrete për shmangien e retorikave të dëmshme, politike dhe diskriminuese, do të garantojnë sigurimin e vendimmarrjeve të azilit bazuar në prova të besueshme.
- Rekomandohet forcimi i bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve të vendeve pritëse me autoritetet vendase shqiptare, komunitetet fetare, organizatat shqiptare joqeveritare dhe median, pasi që të dhënat e grumbulluara dhe të përpunuara nga ana e këtyre aktorëve mund të garantojnë evidenca konkrete për vërtetësinë e rasteve specifike dhe të ndihmojë në verifikimin e legjitimitetit të kërkesave për azil lidhur me gjakmarrjen.
- Marrë shkas se gjakmarrja është pozicionuar si një nga faktorët e migrimit, sipas Strategjisë Kombëtare të Diasporës Shqiptare 2021–2025 dhe të Planit shoqëruar të Veprimit, rekomandohet marrja e masave nga ana e Presidentit të Republikës në cilësinë e drejtuesit të Këshillit Koordinues në luftën kundër Gjakmarrjes për luajtjen e rolit proaktiv në thirrjen e mbledhjeve periodike të Këshillit, me synim diskutimin dhe finalizimin e Strategjisë Kombëtare afatgjatë për parandalimin dhe luftimin e këtij fenomeni. Nëse ato rezultojnë ende të munguara, sugjerohet marrja e masave konkrete nga ana e Këshillit të Ministrave për hartimin e akteve nënligjore, të cilat do të formalizojnë dhe do t'i hapin rrugë bashkëpunimit të Këshillit Koordinues me organet shtetërore dhe qeverisjen vendore, si dhe do të udhëzojnë konstituimin e Sekretariatit Teknik të Këshillit.

1.2. Hapat e ndërmarrë në përditësimin e kuadrit ligjor vendas

Kuadri ligjor aktualisht në fuqi në vendin tonë për migracionin, ndonëse është pjesërisht i përafëruar me *acquis* të BE-së, kërkon rishikime dhe përmirësime për të adresuar sfidat dhe perspektivën në zhvillim në kontekstin e migracionit dhe azilit.

Në vlerësimin e Komisionit Evropian, *“Shqipëria duhet të përditësojë Strategjinë Kombëtare për Migracionin dhe planin e saj të veprimit përkatës. Plani i emergjencës për një numër të konsiderueshëm të mundshëm ardhjesh të migrantëve dhe azilkërkuessve duhet të përditësohet për të përfshirë shpërndarjet e duhura buxhetore dhe modalitete të qarta për nxitjen e tij. Shqipëria duhet të vazhdojë të kërkojë lidhjen e marrëveshjeve apo marrëveshjeve të ripranimit me vendet e origjinës.”⁽¹¹⁾*

⁽¹¹⁾ Komisioni Evropian, Raporti Screening për Shqipërinë, publikuar në 24 Korrik 2023, fq. 88. Akses online: chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-07/AL%20Cluster_1%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf

Nga informacioni zyrtar i përcjellë nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit për Migracionin dhe Azilin pranë Ministrisë së Brendshme⁽¹²⁾, bëhet e ditur se nëpërmjet Grupit Ndërinstitucional të Punës, kjo Ministri po drejton procesin e hartimit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe planit të saj të veprimit. Gjatë konsultimit rezultoi se Strategjia është hartuar narrativisht, ndërkohë që parashikimi buxhetor konsiderohet si thembra e Akilit për finalizimin e këtij procesi të rëndësishëm. Vlen të theksohet se Strategjia e mëparshme Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit hartuar në zbatim të saj, kanë shtrirë efektet e tyre ligjore deri në fund të vitit 2022. Fillimi i vitit 2023 e ka gjetur vendin tonë në mungesë të një strategjie kombëtare, ndërkohë që në muajin shkurt 2023, bëhet e ditur se sekretariati teknik në Ministrinë e Brendshme ka përgatitur raportin përfundimtar të situatës së zbatimit të strategjisë së mëparshme, që është dorëzuar dhe diskutuar në takimet e organizmave monitorues. Drafti i Strategjisë së re i cili është hartuar nga ana e grupit të punës pritet që t'i nënshtrohet procesit të publikimit dhe konsultimit publik, bazuar në ligjin nr. 146/2016 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.⁽¹³⁾

Marrë shkas nga mungesat që kanë shoqëruar fillimisht Strategjinë Kombëtare të vitit 2017, ndër të cilat mungesa e trajtimit të fenomenit të abuzimit me regjimin e vizave, si dhe mos identifikimi i masave për të luftuar shkaqet e migrimit e mos mbështetja nga organet shtetërore ndaj kategorive në nevojë,⁽¹⁴⁾ vlerësojmë se mësimet e nxjerra duhet të shërbejnë në marrjen e masave konkrete nga ana e grupit ndër-institucional për të promovuar dhe avancuar politikat e emigrimit të ligjshëm në BE ose vendet jo-evropiane, apo riintegrimin e shtetasve shqiptarë të rikthyer.

Plani i Kontigjencës është hartuar për herë të parë nga ana e Ministrisë së Brendshme në vitin 2015 (“Plani për reagim ndaj flukseve të përziera migratore”)⁽¹⁵⁾, ndërkohë që në varësi të flukseve migratore, si dhe në zbatim të objektivave strategjike të migracionit nga ana e autoriteteve vendase shtetërore bëhet e ditur se do të përditësohet në vazhdim, si një tjetër rekomandim i KE-së.⁽¹⁶⁾

Edhe më herët, Strategjia e fundit funksionale në vendin tonë për Migracionin 2019-2022, parashikonte ndër të tjera, hartimin e një plani kontigjence, duke përfshirë një plan operacional që mbulon aktivitete të reagimit dhe përgjigjes, i cili duhet të përditësohet.⁽¹⁷⁾ Në bazë të Urdhërit nr. 592, dt. 06.12.2019 “Për ngritjen e Grupit të Punës Mbi miratimin e Planit të Kontigjencës” u bë i mundur

⁽¹²⁾ Shkresë nr. 9903/1 prot., dt. 10.10.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Migracionin dhe Azilin pranë Ministrisë së Brendshme.

⁽¹³⁾ Rezulton se në muajin Qershor 2023, Grupi Drejtues ka prezantuar vizionin dhe objektivat specifike të Strategjisë së re Kombëtare për Migracionin 2024-2030. Akses online: <https://mb.gov.al/migracioni-prezantohet-vizioni-dhe-objektivat-specifike-te-strategjise-se-re-2024-2030/>

⁽¹⁴⁾ KShH, Raport Studimor “Mbi të drejtat dhe liritë e emigrantëve, azilkërkuesve dhe refugjatëve në Shqipëri për periudhën 2012-2017”, publikuar më Korrik 2018, fq. 93. Akses online: <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgclefindmkaj/https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2018/09/Migrantet-Shqip.pdf>

⁽¹⁵⁾ Strategjia Kombëtare për Qeverisjen e Migracionit dhe Planit të Veprimit 2019-2022, versioni Draft, fq. 19. Akses online: <https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2018/11/STRATEGJIA-KOMB%C3%8BTARE-P%C3%8BR-QEVERISJEN-E-MIGRACIONIT-DHE-PLANI-I-VEPRIMIT-2019-2022.doc>

⁽¹⁶⁾ Idem, Shkresë nr. 9903/1 prot., dt. 10.10.2023.

⁽¹⁷⁾ chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgclefindmkaj/https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2021/02/Strategjia-Komb%C3%8BTare-p%C3%8BR-Migracionin-dhe-Plani-i-Veprimit_2019-2022.pdf

hartimi dhe zbatimi i tij.⁽¹⁸⁾ Versionet e përditësuara nuk gjenden të publikuara në faqet zyrtare të institucioneve përgjegjëse për azilin dhe migracionin, transparencë e cila duhet të garantohet kundrejt publikut. Vlerësojmë se prej fazës së vlerësimit e monitorimit të efekteve të planit të mëparshëm të kontigjencës, e në vijimësi përditësimin e atij ekzistues, duhet të merren masa për konsultimin gjithëpërfshirës e joformal paraprak me organizmat ndërkombëtarë në vendin tonë dhe grupet e interesit, përfshirë dhe organizmat joqeveritarë vendas. Duke konsideruar mbështetjen e vazhdueshëm që është ofruar në procese të rëndësishme si hartimi dhe konsultimi i akteve ligjore e atyre nënligjore e rregullatorë, nga ana e organizmave ndërkombëtare, mendojmë se nuk duhet të shmanget kontributi dhe njohuritë praktike që disponojnë aktorët pjesë e sektorit shqiptar të shoqërisë civile, aktivistët dhe ekspertët që kanë në fokus çështjet e azilit dhe migracionit.

Duke parashikuar evoluimin e modeleve të migrimit dhe potencialin vendas për menaxhimin e flukseve në rritje të mbërritjes së migrantëve, është e domosdoshme që Shqipëria të vlerësojë marrjen e hapave të shpejtë dhe të pandërprerë për përmirësimin e Planit të Emergjencës, me synim përbalimin efektiv të situatës së migrantëve dhe azilkërkuesve. Parashikimi i dispozitave të qarta buxhetore dhe modaliteve të qarta për mirë-funksionimin e këtij plani, do të ndihmojë në reagimin e mirë-koordinuar ndërmjet organizmave përgjegjës për përbalimin e flukseve dhe emergjencave që mund të sjellë migracioni i paligjshëm dhe ai i pakontrolluar.

Sa i përket masave të marra nga shteti Shqiptar për lidhjen e marrëveshjeve të ripranimit me shtete të origjinës (prej të cilave vijnë azilkërkuesit apo migrantët e parregullt), Ministria e Brendshme bën me dije se mekanizmi kombëtar dhe politika e kthimeve të imigrantëve në situatë të parregullt në vendet e tyre të origjinës ka hasur pengesa në drejtim të mungesës së marrëveshjeve të ripranimit dhe protokolleve zbatuese me këto vende, kurse në drejtim të legjislacionit tonë kombëtar tashmë janë miratuar procedurat përkatëse në zbatim të ligjit për të huajt për procesin e identifikimit në kufi dhe trajtimit të të gjitha kategorive të imigrantëve, përfshirë ata në situatë vulnerabël, me qëllim referimin e tyre në strukturat përkatëse.⁽¹⁹⁾ Strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Brendshme rezultojnë se kanë draftuar dhe dërguar për ndjekje të mëtejshme të procedurave nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, 10 projekt-marrëveshje ripranimi me vendet e treta të origjinës, të tilla si: Marok, Afganistan, Irak, Iran, Pakistan, Algjeri, Indi, Egjipt, Tunizi, Bangladesh. Ndërkohë që këto projekt-marrëveshje janë përcjellë në rrugë diplomatike pranë vendeve të sipër përmendura për fillimin e negociatave, deri tani autoritetet shqiptare nuk kanë asnjë përgjigje nga ana e këtyre shteteve.⁽²⁰⁾

Duke njohur rëndësinë e bashkëpunimit dypalësh në menaxhimin e migracionit, jo vetëm Shqipëria, por edhe vendet e treta të origjinës duhet të prioritetizojnë negociatat dhe përfundimin e marrëveshjeve të ripranimit. Pavarësisht se formalizimi i këtyre marrëveshjeve mbetet vullnet politik i secilës palë, të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve, e më konkretisht e drejta për të jetuar i lirë (neni 5 KEDNJ) dhe liria e lëvizjes (nenin 2, protokollin 4 KEDNJ), duhet të garantohen dhe të vlerësohen si të drejta

⁽¹⁸⁾ Ministria e Brendshme, “Raporti i Monitorimit mbi Zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2019-2022”, fq. 27, 47. Akses online: chrome-extension://efaidnbnmnibpcjpcglclefindmkaj/https://akpa.gov.al/wp-content/uploads/2021/05/Qershori-2019-Qershori-2020_Raport-vjetor-i-Strategjise-Kombetare-per-Migracionin-2019-2022.pdf

⁽¹⁹⁾ Idem, Shkresë nr. 9903/1 prot., dt. 10.10.2023.

⁽²⁰⁾ Idem.

substanciale njerëzore, përkundrejt hezitimit që kanë shtetet ndaj kësaj kauze.

Përpos vështirësive me të cilat përballen autoritetet vendase përkundrejt lidhjes dhe nënshkrimit të marrëveshjeve të ripranimit me vendet e treta të origjinës, vlerësojmë se një vëmendje e shtuar duhet t'i kushtohet fenomenit në rritje *“brain drain”* (largimit të trurit nga vendi ynë) dhe flukseve të emigrantëve shqiptarë drejt vendeve evropiane, e kthimit të mëpasshëm të tyre në atdhe.⁽²¹⁾ Sipas të dhënave nga INSTAT, rezultojnë se në periudhën 2011-2019, fluksi i emigracionit u shpërnda në mënyrë të barabartë, e më konkretisht: 120.754 persona u larguan për në Itali dhe nuk ishin kthyer deri në vitin 2019; Greqia priti 92.159 emigrantë; dhe 40.468 u larguan për në Gjermani.⁽²²⁾ Përjetimi i flukseve në rritje dalëse, vlerësohet si një faktor që po ndikon në plakjen e popullsisë në vendin tonë.⁽²³⁾ Krahas këtyre statistikave shqetësuese, shpresa se dinamika e migracionit mund të prodhojë kthimin në vitet pasuese të emigrantëve shqiptarë, duhet të studiohet më thellësisht me qëllim zhvillimin e projeksioneve që i shërbejnë riintegritimit efektiv dhe të qëndrueshëm të bashkë-atdhetarëve në momentin e kthimit në vendin tonë.

1.2.1. Rekomandime mbi mirë-menaxhimin e procesit të përditësimit të kuadrit ligjor vendas

- Sugjerohet përfshirja në Strategjinë Kombëtare për Migracionin dhe Planin e Veprimit të elementëve gjithëpërfshirës, por pa u kufizuar në, masat gjithëpërfshirëse të integritimit, protokollat efektive të menaxhimit të kufirit, procedurat e thjeshta të azilit dhe zgjidhje të qëndrueshme për përfshirjen sociale dhe mirëqenien e migrantëve gjatë periudhës së realizimit të procedurës për shqyrtimin e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare. Për më tepër, Plani i Veprimit duhet të përshtatet për të lehtësuar zbatimin e pandërprerë të strategjisë së rishikuar, duke parashikuar mekanizma specifike, autoritetet përgjegjëse dhe shpërndarjen e burimeve të nevojshme financiare e njerëzore për zbatimin efektiv të saj.
- Duke krijuar një kuadër të fortë ligjor që përshkruan mekanizmat efikase të reagimit, strategjitë e shpërndarjes së burimeve dhe mekanizmat e koordinimit ndërmjet aktorëve përkatës, Shqipëria mund të garantojë dhënien e një përgjigjeje më të koordinuar dhe më efektive ndaj krizave të mundshme të migracionit, duke minimizuar kështu pasojat sociale, ekonomike dhe të sigurisë që lidhen me flukset e papritura të migrantëve dhe azilkërkuesve.

⁽²¹⁾ Sipas të dhënave nga INSTAT për vitin 2022, 46,460 shqiptarë janë larguar si emigrant. Kjo shifër rezultojnë të jetë 10.5% më e lartë se ajo e vitit 2021, kur numri i të ikurve ishte rreth 42 mijë. Por, ajo që bie në sy nga statistikat publike në rastin e popullsisë është fakti se emigrimi në vitin 2022 ka prekur nivelin më të lartë që prej vitit 2014.

⁽²²⁾ INSTAT, “Diaspora e Shqipërisë në shifra”, fq. 27. Akses online: <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://www.instat.gov.al/media/7848/diaspora-ne-shifra-2020.pdf>

⁽²³⁾ Idem, INSTAT, fq. 24.

- Formalizimi i marrëveshjeve të ripranimit me vendet e treta të origjinës të azilkërkuesve apo migrantëve të parregullt, e ndihmon Shqipërinë në krijimin e një kornize ligjore për kthimin e rregullt dhe në kohë të migrantëve të parregullt e atyre që iu refuzohet kërkesa për mbrojtje ndërkombëtare, duke lehtësuar kështu një qasje më sistematike dhe të qëndrueshme ndaj menaxhimit të migracionit. Për më tepër, marrëveshje të tilla nxisin bashkëpunim të zgjeruar, mirëkuptim të ndërsjellë dhe përgjegjësi të përbashkët midis shteteve, duke kontribuar kështu edhe në stabilitetin dhe sigurinë e përgjithshme të rajonit.

1.3. Trajtimi i azilkërkuesve dhe kapacitetet institucionale vendase për trajtimin dhe menaxhimin e tyre, nën optikën e Komisionit Evropian

Fluksi i shtetasve të huaj në Shqipëri mund të thuhet me bindje se është bërë një tipar domethënës, i cili vlen të analizohet për të kategorizuar migrantët të cilët zgjedhin vendin tonë për mundësi punësimi, arsimimi, azili dhe strehimi. Zhvillimet pozitive kulturore dhe në fushën e turizmit, kanë ndikuar në përjetimin e një ndryshimi të dukshëm për vendin tonë, nga një vend burimi në atë destinacion.

Të dhënat e ndara nga ana e institucioneve vendase përgjegjëse me Komisionin Evropian, të bëra publike në Raportin Screening, tregojnë se në mbyllje të vitit 2021, numri i individëve që zotëronin një leje qëndrimi të vlefshme në Shqipëri arriti në 14,921, duke reflektuar një tendencë të dukshme rritëse në tërheqjen e vendit për shtetasit e huaj. Rritja e ndjeshme e numrit të aplikimeve për leje qëndrimi, e cila arriti në 9,106 në vitin 2021, nënvizon një rritje të numrit të individët që kërkojnë strehim afatgjatë dhe e shohin Shqipërinë si një destinacion të qëndrueshëm. Megjithatë, ky tranzicion nuk ka qenë pa sfida. Shqipëria është përballur me rolin e të qenit një vend tranzit, veçanërisht për emigrantët e parregullt me origjinë nga Lindja e Mesme dhe Afrika e Veriut, të cilët synojnë të përshkojnë vendin tonë gjatë rrugës për në vende të ndryshme anëtare të Bashkimit Evropian. Kjo situatë ka paraqitur sfida të konsiderueshme logjistike dhe humanitare, duke kërkuar një qasje gjithëpërfshirëse për menaxhimin e fluksit të migrantëve të parregullt, nën nevojën për të respektuar standardet ndërkombëtare të të drejtave dhe dinjitetit të njeriut.

Infrastruktura që kujdeset për pritjen e migrantëve ka dëshmuar përmirësime të pjesshme. Më konkretisht në vendin tonë, dy vendqëndrimet akomoduese të parashikuara në ligjin nr. 10/2021 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 79/2021 “Për të huajt”, janë Qendra e Pritjes për Azil (në Babrru)⁽²⁴⁾ dhe Qendra e Mbyllur për të Huajt (në Kareç).⁽²⁵⁾

⁽²⁴⁾ Sipas nenit 3 pika 27 e ligjit nr. 10/2021 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se Qendra e Pritjes për Azil është struktura e caktuar për pranimin dhe akomodimin kolektiv të kërkuesve për mbrojtje ndërkombëtare.

⁽²⁵⁾ Parashikuar në nenin 114 të ligjit nr. 79/2021 “Për të huajt”.

Diferencimi kyç ndërmjet kategorizimit të të akomoduarve në këto institucione konsiston në statusin procedural ligjor të njohur ndaj tyre, konkretisht në Qendrën e Pritjes për Azil pranohen dhe akomodohen të gjithë kërkuesit që kanë depozituar kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në vendin tonë, ndërkohë që në Qendrën e Mbyllur për të Huajt mundësohet akomodimi i shtetasve të huaj që janë subjekt dëbimi nga territori i Republikës së Shqipërisë.

Vlerësimi i Komisionit Evropian mbi infrastrukturën e autoriteteve përgjegjëse për të huajt dhe migracionin mbetet “*Stafi i përgjithshëm i Departamentit të Kufirit dhe Migracionit të PSH-së mbetet i kufizuar, pavarësisht rritjeve të fundit. Strukturat e përbërshme të trajnimit duhet të krijohen në përputhje me standardet bazë të trajnimit për rojet kufitare të BE-së. Kapaciteti i qendrave të pritjes është i mjaftueshëm për presionin e migracionit me të cilin përballlet Shqipëria aktualisht. E vetmja qendër e mbyllur e pritjes për shtetasit e vendeve të treta që janë objekt i procedurave të kthimit ende pret rinovimin urgjent. Shqipëria duhet të sigurojë kapacitete të përshtatshme pritëse dhe të krijojë alternativë ndaj paraburgimit për fëmijët, gratë në rrezik dhe personat me kushte të rënda mjekësore, siç parashikohet në Ligjin për të huajt. Koordinimi me departamentet e mbrojtjes së fëmijëve dhe antitrafikimit duhet të përmirësohet. Duhet të trajtohet qarkullimi i lartë i oficerëve në kufi. Oficerët e Policisë Kufitare dhe të Migracionit duhet të rrisin kapacitetet e tyre për të identifikuar refugjatët dhe migrantët me nevoja specifike. Të miturit e pashoqëruar që udhëtojnë nga Shqipëria drejt vendeve anëtare të BE-së janë një burim shqetësimi. Vëmendje më e madhe duhet t’i kushtohet riintegrimin të suksesshëm të të kthyerve, veçanërisht atyre më vulnerabël. Sportelet e migracionit të ngritura në bashki duhet të formalizohen dhe forcohen për të lehtësuar riintegrimin dhe më shumë oficerë policie duhet të vazhdojnë të trajnohen për të shoqëruar të kthyerit në Shqipëri. Për sa i përket kërkesës së përsheptuar të integrimin, ka nisur procesi që Shqipërisë t’i jepet statusi i vëzhguesit në Rrjetin Evropian të Migracionit.*”⁽²⁶⁾

1.3.1. Paraqitja e të dhënave statistikore mbi azilkërkuesit për periudhën Janar-Dhjetor 2022 dhe Janar-Korrik 2023

Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga Autoriteti Përgjegjës për Kufirin dhe Migracionin, më konkretisht Sektori i Azilit dhe të Huajve pranë Ministrisë së Brendshme⁽²⁷⁾, për vitin 2022, janë regjistruar 125 kërkesa për mbrojtje ndërkombëtare në formën e azilit në Republikën e Shqipërisë. Ndërkohë që për periudhën 7 mujore, Janar - Korrik 2023, vërehet një rritje e numrit të kërkesave e më konkretisht 123 kërkesa për azil.


Sa i përket specifikimeve të azilkërkuesve sipas vendit të origjinës, rezulton se për periudhën

⁽²⁶⁾ Komisioni Evropian, Raporti Screening për Shqipërinë, publikuar në 24 Korrik 2023, fq. 88-89. Akses online: chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-07/AL%20Cluster_1%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf

⁽²⁷⁾ Informacion i përcjellë nga Sektori i Azilit dhe të Huajve, nëpërmjet email datë 09.10.2023, Disa nga përgjigjet e adresuara për pyetje specifike janë koordinuar në bashkëpunim me Qendrën e Pritjes për Azil

Janar-Korrik 2023 ka një rritje të numrit të shtetasve nga vendet e Lindjes së Mesme, e më konkretisht nga shtete si Afganistan, Irak, Iran, Somali dhe Jemen.

Azilkërkues sipas vendit të origjinës (2022-2023)



	IRAK	SIRI	MAROK	ALGJERI	PAKISTAN	AFGANISTAN	UKRAINE	RUSI	USA	IRAN	EGJIPT	TUNIZI	SOMALI	JEMEN	BANGLADESH	SERBI
Janar-Korrik 2023	15	0	0	0	0	81	2	0	0	5	1	0	14	5	0	0
Viti 2022	18	5	2	3	7	36	27	10	1	6	0	3	1	0	3	2

Në analizë të këtij trendi në rritje, është e domosdoshme që autoritetet përkatëse të zbatojnë masa të përgjegjshme dhe proaktive që kanë prioritet mbrojtjen dhe mirëqenien e azilkërkuesve, duke garantuar gjithashtu integritetin dhe efikasitetin e procesit të azilit. Për më tepër, nxitja e bashkëpunimit dhe dialogut ndërkombëtar, si dhe eksplorimi i zgjidhjeve të qëndrueshme, do të jetë instrument i rëndësishëm në adresimin e çështjeve komplekse që nënvizojnë rritjen e fundit të kërkesave për azil në Republikën e Shqipërisë.

Për vitin 2022, në përfundim të procedurës për azil rezultoi se kanë plotësuar kriteret për të fituar statusin e mbrojtjes ndërkombëtare 24 azilkërkues, nga 125 (pra 19.2%). Gjatë vitit 2022 nuk rezultoi që të ketë pasur vendime refuzimi për mbrojtje ndërkombëtare. 18 persona rezultoi se kanë ndërprerë procedurat për mbrojtje ndërkombëtare, duke tërhequr kërkesën për azil në RSH ose duke u vetë-larguar pa njoftuar nga Qendra Pritëse për Azil. Të dhënat e vëna në dispozicion e nga ana e autoritetit përgjegjës krijojnë paqartësi për fatin e kërkesave të 83 të huajve që kanë regjistruar kërkesat për mbrojtje ndërkombëtare (azil), por që mungon informacioni mbi vijueshmërinë e procesit.

Gjatë periudhës Janar-Korrik 2023, në përfundim të procedurës për azil rezultoi se kanë plotësuar kriteret për të fituar statusin e mbrojtjes ndërkombëtare 11 azilkërkues, nga 123 (pra 8.9%). Njëjtë si në vitin 2022, edhe në këtë periudhë kohore të vitit 2023 nuk ka pasur vendime refuzimi. Ndërsa 3 persona kanë ndërprerë procedurat për mbrojtje ndërkombëtare (azil). Edhe në këtë rast, të dhënat ofrojnë paqartësi për fatin e kërkesave të diferencës prej 103 azilkërkues. Gjatë konsultimit, përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme bënë të ditur se këta azilkërkues janë larguar, e autoritetet vendase nuk kanë dijeni mbi vendndodhjen e tyre.

Nga ana tjetër, mosdhënia e vendimeve të refuzimit të mbrojtjes ndërkombëtare ndaj këtyre shtetasve nga ana e Autoritetit përgjegjës për Azilin në Ministrinë e Brendshme passjell mungesën e ankimeve panë Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët. Theksojmë se më herët, KShH ka

qenë anëtar i këtij Komisioni, por prej vitit 2021 në një formë regressive, u vendos ndryshimi i përbërjes së Komisionit nëpërmjet VKM nr. 669, dt. 10.11.2021⁽²⁸⁾. Mbi këtë çështje KShH ka reaguar nëpërmjet një letre të hapur⁽²⁹⁾ drejtuar Ministrit të Brendshëm të asaj kohe, ndërkohë që nga ky i fundit në procesin e një interpelance parlamentare u bë e ditur ftesa ndaj KShH-së dhe ndaj çdo organizate joqeveritare për të ndjekur në cilësinë e të ftuarit mbledhjet e Komisionit. KShH nuk është ftuar në asnjë mbledhje të planifikuar, e mesa duket nga të dhënat mbledhjet kanë qenë të munguara, por nga ana tjetër kriteret e parashikuara për t'u përmbushur për anëtarët e Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët (si pajisja me certifikatë sigurie niveli 'sekret') nëse shtrihen edhe mbi të ftuarit krijojnë vështirësi në ndjekjen potenciale e efektive të këtyre mbledhjeve nga ana e të ftuarve pjesë e sektorit të shoqërisë civile.

Për më tepër, numri i shtetasve të huaj që kanë ndërprerë procedurat për mbrojtje ndërkombëtare (azil) në mënyrë të papritur, duhet të analizohet me kujdes nga ana e strukturave përgjegjëse. Mungesa e qartësisë së Autoritetit Përgjegjës për rrethanat që i kanë shtyrë këta shtetas për të ndërprerë këtë procedurë krijon një hije pasigurie mbi fatin e këtyre individëve, duke i lënë situatat e tyre të pazgjidhura dhe duke vënë në rrezik mirëqenien e tyre.

Të dhënat jo të plota mbi diferencën statistikore ndërmjet totalit të shtetasve që kanë depozituar kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, atyre që kanë përmbushur kriteret dhe kushtet ligjore për të përfituar statusin e azilkërkuesit, si dhe atyre që kanë ndërprerë procedurën përkatëse ligjore në mënyrë vullnetare, mund të konsiderohet e ndërlikuar me mungesën e veprimeve vendimtare nga ana e autoriteteve përgjegjëse.

1.3.2. Kapacitetet akomoduese dhe infrastrukturore të Qendrës së Pritjes për Azil (Babrru)

Sa i përket të dhënave të referuara për vitin 2022 (periudha Janar-Dhjetor 2022) dhe periudhën 7 mujore Janar-Korrik 2023, nga ana e autoritetit përgjegjës bëhet e ditur se kohëzgjatja minimale e qëndrimit të azilkërkuesve në Qendrën e Pritjes është 3-4 ditë. Sa i përket kohëzgjatjes mesatare të qëndrimit ajo referohet 10-15 ditë, ndërkohë që kohëzgjatja maksimale përllogaritet 8-10 muaj.

Në përputhje me nenin 44 të ligjit nr. 10/2021 "Për Azilin në Republikën e Shqipërisë", Qendra e Pritjes për Azil duhet të garantojë kushtet minimale të jetesës, duke përfshirë akomodimin; ushqimin; sigurimin shëndetësor; kushtet minimale të higjienës. Gjithashtu, në kuadër të partneriteteve

⁽²⁸⁾ Publikuar në FZ nr. 175, dt. 11.11.2021. Akses online: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2021/11/10/669/fea13562-1449-4767-9ed9-9abba882ac1e>

⁽²⁹⁾ Letër e Hapur "KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT PËRJASHTOHET PA ARSYE NGA ANËTARËSIA NË KOMISIONIN KOMBËTAR PËR AZILIN DHE REFUGJATËT", publikuar më 13 Prill 2022. Akses online: https://ahc.org.al/leter-e-hapur-komiteti-shqiptar-i-helsinki-per-jashtohet-pa-arsye-nga-anetaresia-ne-komisionin-kombetar-per-azilin-dhe-refugjatet/#_ftn3

me subjekte të ndryshme, Qendra në përputhje me të drejtat e kërkuesve e të refugjatëve, zhvillohen programe pedagogjike e edukuese, si dhe këshillim ligjor falas.

Kategorizimi i shtetasve që vijnë dhe akomodohen në Qendrën e Pritjes për Azil realizohet nga Drejtoria përgjegjëse e Kufirit dhe Migracionit, në bazë të vlerësimit të nevojave që identifikohen dhe referohen si: familje, shtetas të vetëm, persona me aftësi ndryshe, fëmijë të pashoqëruar etj.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 dhe Janar-Korrik 2023, rezulton se nuk ka pasur raste të shtetasve që kanë përfutur statusin e refugjatit/mbrojtjes plotësuese të cilët janë larguar nga Shqipëria me dëshirën e tyre, por gjatë periudhës së sipërcituar përpara shqyrtimit nëpërmjet procedurës së kërkesës së tyre për azil, rreth 3,137 shtetas afganë kanë tërhequr kërkesën e tyre për mbrojtje të përkohshme dhe janë larguar me dëshirë nga vendi ynë. Këto të dhëna statistikore krijojnë premisa për kategorizimin e vendit tonë si një vend i migracionit tranzit, i cili nuk është destinacion për këta shtetas.

Qendra e Pritjes për Azil ka kapacitet pritës për 220 persona, ndërkohë që aktualisht në të ushtrojnë funksionin rreth 15 punonjës dhe 3 punonjës shtesë me kontratë nga Ministria e Brendshme. Sa i përket burimeve njerëzore, ndër nevojat e identifikuar nga vetë Qendra, referohen pamjaftueshmëria në burime njerëzore, përkatësisht: specialist IT, Specialist Finance, Mjek, Infermier, Punëtor, Mirëmbajtës, Kujdestar Nate, Sanitar dhe Punonjës Socialë.

Misioni i fundit monitorues i KShH-së në Qendrën e Pritjes për Azil i përket periudhës Qershor 2019. Së fundmi, KShH ndërmori iniciativën për monitorimin e këtij institucioni nisur nga praktika e përdorur dhe bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet KShH-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Megjithatë detyrimi për hartimin dhe nënshkrimin e një marrëveshjeje të drejtpërdrejtë me Qendrën e Pritjes për Azil ka bërë që ky proces tashmë të varet nga finalizimi dhe miratimi i këtij akti të përbashkët.

Në vizitën e mëhershme monitoruese, vëzhguesit e KShH-së nxorën në pah mungesën e parashikimit në organikë të funksionit të juristit, ndërkohë që Drejtoria e e Kufirit dhe Migracionit, si dhe e organizata RMSA individualizohen si partnerë kryesorë në asistimin ligjor falas të azilkërkuesve. Sa konstatohet nga informacioni shkresor i referuar nga ana e Autoritetit përgjegjës kjo vakancë tashmë është shmangur. Megjithatë, më herët mungesa dhe vështirësi janë hasur edhe nga ana e stafit përgjegjës psikolog, mjek, përkthyes të gjuhëve të veçanta si arabe etj.⁽³⁰⁾ Sa kohë që burimet njerëzore aktuale, si dhe menaxhimi i situatave prej tyre nuk ka qenë objekt i monitorimit nga KShH, nuk mund të ofrojmë të dhëna të përditësuar dhe absolutisht vështirësitë e pengesat e mëhershme nuk kanë si qëllim paragjykimin apo keqinformimin mbi kushtet aktuale, por administrata aktuale funksionale prej 18 punonjësish vlerësojmë se nuk konsiderohet në proporcionalitet të arsyeshëm me kapacitetin prej 123 personash që kanë depozituar kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në periudhën Janar-Korrik 2023.

⁽³⁰⁾ Për më shumë rreth të dhënave mbi gjetjet e misionit monitorues, lexoni “Raport Monitorimi - Mbi të drejtat dhe liritë e emigrantëve, azilkërkuesve dhe refugjatëve në Shqipëri”, hartuar nga KShH, fq. 35 e vijues. Akses online: chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/03/Raport-monitorimi_Mbi-te-drejtat-dhe-lirite-e-emigranteve-azilkerkuesve-dhe-refugjateve-ne-Shqiperi_compressed.pdf

1.3.3. Rekomandimet e UNICEF⁽³¹⁾ mbi vlerësimin e nevojave, vulnerabilitetit dhe eksperiencës së të miturve shqiptarë dhe atyre të huaj në kontekstin e migracionit

Vitet e fundit, të dhënat nga burime të besueshme kanë treguar vazhdimisht se përkundrejt të rriturve, të rinjtë e moshës 15 deri në 29 vjeç përbëjnë grupin e dytë më të madh të migrantëve ndër-kombëtarë. Kjo prirje ka vazhduar që nga viti 1990, duke nxjerrë në pah nevojën urgjente për një qasje të fokusuar në adresimin e nevojave, dobësive dhe përvojave të fëmijëve në kontekstin e migracionit, shqiptarë dhe joshqiptarë. Rekomandimet e UNICEF-it përshkruajnë një narrativë që nënvizon aspektet kritike të kësaj përpjekjeje. Duhet theksuar se çdo veprim i ndërmarrë në lidhje me fëmijët në lëvizje duhet të ketë prioritet interesin e tyre më të mirë dhe mosdiskriminimin, duke vendosur mirëqenien e tyre mbi statusin e tyre të migrimit. Qasja në azil për fëmijët, qofshin ata të ardhur me familjet e tyre apo të pashoqëruar, konsiderohet thelbësore dhe duhet mbrojtur.

1.3.3.1 Qasja në shërbime miqësore të azilit dhe mbrojtjes për fëmijët

- Interesi më i mirë i fëmijës dhe parimi i mosdiskriminimit duhet të jenë konsiderata kryesore në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët në lëvizje dhe duhet të kenë përparësi ndaj statusit të migracionit.
- Duhet të ruhet qasja në azil për fëmijët nëse ata janë në familje ose vijnë të ndarë ose të pashoqëruar.
- Krijimi dhe sigurimi i kushteve cilësore të pritjes të përshtatshme për fëmijët dhe mjedise të sigurta për fëmijët dhe gratë, veçanërisht fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë në mbërritje, duke përfshirë sigurimin e qasjes në azil dhe shërbime mbrojtëse që janë të përshtatshme për moshën dhe gjininë, sistemet e kujdestarisë, aksesin në shërbimet bazë - arsimin, shëndeti mendor dhe mbështetja psikosociale, mbrojtja sociale, programet e trajnimit dhe aftësive, dhe mbështetja e integritetit.
- Zhvillimi dhe promovimi i standardeve minimale për strehimin e përkohshëm dhe qendrat e pritjes që presin fëmijë refugjatë, migrantë dhe azilkërkues.
- Identifikimi i fëmijëve të pashoqëruar dhe të ndarë, duke siguruar akses në këshillim ligjor dhe mbështetje për kujdestarinë në azil ose procedura të tjera ligjore dhe të përkohshme të zbatueshme.

⁽³¹⁾ Fullani, A., Alimehmeti, E., Të pashoqëruar dhe të pambrojtur: Vlerësimi i mangësive në mbrojtje për fëmijët e huaj të pashoqëruar në Shqipëri, UNICEF Shqipëri, Tiranë 2023.

1.3.3.2 Forcimi i Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve

- Rritja e kapaciteteve të fuqisë punëtore të shërbimit social, veçanërisht në lidhje me menaxhimin e rasteve, kujdestarinë ligjore, mbrojtjen dhe dhunën me bazë gjinore dhe të sigurojë që fëmijët refugjatë, migrantë dhe azilkërkues të gëzojnë të njëjtat të drejta si fëmijët vendas me akses adekuat në shërbimet bazë.
- Shërbime alternative të kujdesit në familje dhe në komunitet për fëmijët, si për fëmijët refugjatë, migrantë dhe azilkërkues dhe fëmijët vendas, nëpërmjet disponueshmërisë së një sërë opsionesh të kujdesit gjithëpërfshirës dhe alternativ të aksesueshme për të gjithë fëmijët, pavarësisht nga kombësia e tyre.

1.3.3.3 Përfshirja e fëmijëve refugjatë dhe migrantë në sistemet kombëtare të mbrojtjes së fëmijëve

- Inkurajimi i sistemeve kombëtare që të zhvillojnë më tej lidhjet midis përgjigjeve të refugjatëve dhe migrantëve dhe sistemeve të mbrojtjes së fëmijëve që forcohen për t'iu përgjigjur emergjencave humanitare dhe të tjera dhe të ndërtojnë kapacitete për fëmijët vendas në të njëjtën mënyrë (si shembull, modeli aktual i përgjigjes që UNICEF ka mbështetur në Shëngjin për afganët nën statusin e mbrojtjes së përkohshme në partneritet me ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri).
- Promovimi i integritimit në sistemet kombëtare të shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve për fëmijët refugjatë/migrantë (përfshirë identifikimin e rasteve të mbrojtjes së fëmijëve, menaxhimin e rasteve dhe kujdestarinë), bazuar në parimin e interesit më të mirë të fëmijës, dhe me fokus në UASC si një grup vulnerabël.

1.3.3.4. Forcimi i bazës së provave për fëmijët në lëvizje.

- Promovimi i zhvillimit të sistemeve kombëtare për mbledhjen e të dhënave zyrtare për fëmijët refugjatë, migrantë dhe azilkërkues në përgjithësi, dhe fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë në veçanti, të ndara sipas moshës, gjinisë dhe paaftësisë.

Përveç kësaj, hulumtimi i udhëhequr nga UNICEF sugjeron se ka boshllëqe ligjore dhe kapacitetesh për të mbrojtur fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë që vijnë në Shqipëri. Vlerësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator vendas në lidhje me të drejtat, trajtimin dhe mbrojtjen e fëmijëve të huaj të pashoqëruar dhe të ndarë që mbërrijnë në territorin shqiptar tregon nevojën për ndryshime të rëndësishme ligjore, krahas ndryshimeve të planeve të masave praktike të koordinimit, bashkëpunimit efektiv dhe zhvillimit të kapaciteteve në institucionet përkatëse. Plotësimi i kuadrit rregullator dhe adresimi i kapaciteteve institucionale për zbatimin e tij janë nevoja imediate dhe me rëndësi parësore në forcimin e autoriteteve shtetërore dhe palëve të interesuara për t'iu përgjigjur efektivisht migracionit, duke parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës ndaj fëmijëve dhe trafikimit të qenieve njerëzore.

1.3.4. Të dhëna statistikore dhe gjetje e rekomandime në kuadër të misionit monitorues të KShH-së në ambientet e Qendrës së Mbyllur Kareç

Të dhënat e vëna në dispozicion nga ana e Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit reflektojnë se në raport ndërmjet vitit 2022 dhe 2021, kemi një diferencë të lehtë të vërejtur në raport me transferimet e shtetasve të huaj për në Qendrën e Mbyllur Kareç, pas kapjes së tyre në kufi/territor vendas. Më konkretisht, në vitin 2021 janë identifikuar 69 shtetas të huaj, ndërsa në vitin 2022 numërohen 65 shtetas. Një rritje prej 11 shtetas më shumë është vërejtur edhe gjatë periudhës 9 mujore të vitit 2023 (34 shtetas të huaj), në raport me numrin e shtetasve të huaj në të njëjtën periudhë kohore 9 mujore që i përket vitit 2023 (23 shtetas të huaj).

Në muajin Mars 2023, KShH ndërmori një vizitë monitoruese në ambientet e Qendrës së Mbyllur Kareç. Funksionimi i këtij institucioni bëhet i mundur në sajë të VKM nr. 1083, datë 28.10.2009 “Për ngritjen e Qendrës së Mbyllur”, i detajuar nëpërmjet Urdhrit nr. 117, date 09.02.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për miratimin e Rregullores së Brendshme mbi Organizimin dhe Funksionimin e Qendrës së Mbyllur për të Huajt”.

Kapaciteti institucional i kësaj qendre mundëson akomodimin e rreth 100 persona, megjithatë në ditën e monitorimit vetëm 10 shtetas të huaj janë konstatuar në institucion. Në vlerësimin e KShH-së, ndryshimi i ligjit nr. 79/2021 “Për të huajt” duhet të shoqërohej edhe me adresimin e propozimit ndaj KM për miratimin e një vendimi të ri për përmirësimin e funksionimit të Qendrës, si dhe përditësimin e Rregullores së Brendshme mbi organizimin e këtij institucioni, sipas nevojës.

Në organikën aktuale janë parashikuar 37 punonjës, për të përmbushur detyrimet ligjore dhe aktivitetin normal të institucionit, ndërkohë që asnjë vakancë nuk referohet aktualisht. Duke mbajtur në konsideratë numrin e personave të akomoduar (kryesisht në situata fluksi), kohën e qëndrimit të tyre, si dhe nevojat përkatëse të të akomoduarve, me synim garantimin e respektimit të të drejtave dhe lirive të shtetasve të huaj, është sugjeruar bashkëpunimi i ngushtë me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Pavarësisht vullnetit pozitiv të specialistëve të stafit aktual, por edhe të ndaluarve në raport me njëri-tjetrin, është vlerësuar si i domosdoshëm angazhimi me kohë të plotë i përkthyesve të licencuar për garantimin e ndarjes së informacionit të saktë dhe objektiv. Gjithashtu, mungesa e parashikimit në organikë të pozicionit të juristit, pavarësisht përpjekjeve për ofrimin e asistencës ligjore në bashkëpunim me organizma ndërkombëtare, në vlerësimin e KShH-së nuk garanton ofrimin e asistencës juridike sistematike nga profesionistë të fushës. Qasja gjithëpërfshirëse dhe organike për ofrimin e asistencës ligjore ndaj shtetasve të ndaluar të akomoduar në Qendrën e Mbyllur duhet të përfshijë krijimin e një infrastrukture të qëndrueshme që nxit angazhimin e vazhdueshëm të profesionistëve ligjorë dhe palëve të interesuara, që siguron integritetin e ekspertizës ligjore vendase dhe i jep përparësi zhvillimit të strategjive afatgjata për të adresuar nevojat komplekse ligjore të kësaj kategorie.

Në përfundim të këqyrjes vizuale të ambienteve është vërejtur prezencë shqetësuese e lagështirës, erë e rëndë myku, mungesë e ngrohjes së ambientit, si dhe tavane të amortizuara, elementë që krijojnë pikëpyetje për trajtimin human dhe respektimin e nenit 3 KEDNJ. Nëpërmjet informacionit të

përcjellë nga institucioni objekt monitorimi u bë e ditur se specialistët e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit kanë evidentuar problematikën dhe në bashkëpunim me IOM është parashikuar që së shpejti të fillojnë punimet për rikonstruksionin e institucionit.⁽³²⁾

Duke njohur peshën e situatës së konstatuar në terren, si dhe duke vlerësuar partneritetin e mbështetjen e ofruar nga organizmat ndërkombëtare ndaj autoriteteve vendase, në mungesë të hapësirave buxhetore institucionale, ritheksojmë urgjencën e ndërhyrjeve të shpejta, nisur nga hartimi i një plani ndërhyrjesh që synon adresimin e çështjeve imediate.

Vëzhguesit e KShH-së rekomanduan marrjen e masave për pasurimin e bibliotekës së institucionit me libra në gjuhën angleze ose arabe, si dhe botime të reja që tërheqin vëmendjen e të akomoduarve. Gjithashtu, aktivitetet sportive, rekreative e social-kulturale në ambientet e jashtme të institucionit, të konstatuara si të pakta nga vëzhguesit e KShH-së, u argumentua nga ana e institucionit me mungesën e disponimit të një buxheti të dedikuar për përshtatjen e ambienteve. Në mirëkuptim të argumentimit të adresuar, KShH sugjeron prioritizimin e zhvillimit të ambienteve të jashtme në kuadër të alokimit të përgjithshëm buxhetor. Një strategji e mundshme e rekomandueshme përfshin nxitjen e partneriteteve me aktorë të jashtëm, duke përfshirë komunitetet lokale, bizneset dhe organizatat joqeveritare, për të siguruar fonde dhe burime shtesë për përmirësimin e mjediseve të jashtme. Bashkëpunimi me këta aktorë u mund të kultivojë një ndjenjë të përgjegjësisë së përbashkët dhe angazhimit të komunitetit në nxitjen e një mjedisi rekreativ social, përveç mbështetjes financiare.

Në Qendër është konstatuar i munguar sistemi kartofonik, ndërkohë që komunikimi i të ndaluarve me botën e jashtme realizohet nëpërmjet aparateve telefonikë celularë personalë, nën mbikëqyrjen e stafit institucional. Nga ana e institucionit objekt monitorimi është bërë e ditur se rrjeti satelitor nuk ka funksionuar prej ngritjes së Qendrës. KShH rithekson marrjen e masave për të mundësuar komunikimin në privatësi të të ndaluarve, nëpërmjet aparateve kartofonike, siç kërkohet nga neni 1, kreu II, pjesa e III VKM nr. 1083/2009. Në këndvështrimin e KShH-së, çdo zgjidhje ekstraligjore mund të përbëjë shkak për cenim të sigurisë, privatësisë dhe të dhënave personale të shtetasve të akomoduar në këtë institucion dhe/ose familjarëve apo miqve të tyre.

Gjatë bashkëbisedimit me të akomoduarit në Qendër, vëzhguesve të KShH-së iu pretendua dalja në ajrim vetëm në muajin e fundit, pasi kjo e drejtë ishte kufizuar pa një argumentim justifikues. Në institucion nuk ekziston një regjistër i posaçëm për dokumentimin e pjesëmarrjes së shtetasve të akomoduar, në veprimtari dhe aktivitete të përbashkëta apo edhe për ajrimin e tyre në ambientet e jashtme të dedikuara të Qendrës. Nga ana e institucionit objekt monitorimi, ky pretendim u hodh poshtë me argumentimin se gjatë periudhës së verës është mundësuar dalja në ajrim të të ndaluarve, dyfishin e kohës të përcaktuar në regjimin ditor.

Në dritën e kësaj korrespondence të shkëmbyer me institucionin objekt monitorimi, vlerësojmë si të domosdoshme marrjen e masave konkrete për rivlerësimin e politikave dhe praktikave brenda Qendrës për të siguruar mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave themelore dhe mirëqenies së shtetasve të akomoduar. Pamundësia për të dokumentuar në mënyrë sistematike nivelin e garantimit të së drejtës së ajrimit dhe përfshirjen e të akomoduarve në aktivitete të përbashkëta, përbën një sfidë konkrete e ndikuese në vlerësimin e mirëqenies së përgjithshme të të ndaluarve dhe sigurimin e efektivitetit të

⁽³²⁾ Shkresë nr. 971/1 prot., dt. 17.05.2023 “Kthim përgjigje shkresës nr. prot. 284, datë 27.04.2023, mbi rekomandimet dhe monitorimet e Komitetit Shqiptar të Helsinkit”, përcjellë nga Qendra e Mbyllur për të Huajt

programeve dhe nismave institucionale. Nga procesi konsultues i realizuar në tryezën e përbashkët të dt. 8 nëntor 2023 (rreth 8 muaj më vonë nga procesi i verifikimit në terren), autoritetet përgjegjëse të këtij institucioni bënë të ditur se përmirësimet infrastrukturore të ndërmarra së fundmi pasqyrojnë një realitet ndryshe. Si rrjedhojë, KShH vlerëson nevojën për realizimin e një tjetër vizite verifikuese në terren, me synim nxitjen e promovimit të praktikave pozitive të reflektimit nga ana e autoriteteve vendase kundrejt nevojës për ofrimin e kushteve adekuate ndaj shtetasve të huaj.

1.4. Përpunimi i të dhënave statistikore dhe cilësore mbi identifikimin dhe trajtimin e imigrantëve të parregullt

Nga informacioni i përcjellë nga ana e Departamentit për Kufirin dhe Migracionin rezulton se gjatë periudhës 9 mujore Janar-Shtator 2023, në vendin tonë janë kapur gjithsej 5,804 shtetas të huaj imigrantë të parregullt, ku 4,139 kanë qenë autorë për herë të parë dhe 1,665 përsëritës. Kjo shënon një ulje të ndjeshme prej 3,071 rastesh, që paraqet një rënie prej -34% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë (2022). Mendohet se ndikim në rënien e kurbës kanë pasur kontrollat e shtuara në kufirin e gjelbër në zonën operacionale Kakavijë/Kapshticë, ku dhe janë dislokuar forcat e FRONTEX-it. Gjatë 9 mujorit të vitit 2022, u kapën 8,875 imigrantë të parregullt, ku 6,059 ishin shkelës për herë të parë dhe 2,816 përsëritës. Në total në vitin 2022, në vendin tonë janë lokalizuar dhe kapur 11,216 imigrantë të parregullt (8,335 për herë të parë dhe 3,881 përsëritës). Viti 2022 konsiderohet një periudhë që ka numëruar një shifër më të ulët të numrit të imigrantëve të parregullt, krahasuar me vitin 2021, gjatë të cilit rezultojnë të jenë lokalizuar dhe kapur në vendin tonë 18,496 ose rreth 66% shtetas të huaj imigrantë të parregullt (10,062 për herë të parë dhe 8,434 prej tyre përsëritës). Vlerësojmë se përpos rëndësisë që paraqet analiza e të dhënave statistikore mbi numrin e imigrantëve të parregullt për herë të parë, numri i shtetasve recidivistë në një raport rreth 50% ndërmjet dy viteve, vlen të studiohet në një formë empirike dhe të thelluar, në mënyrë që të përkthehet në masa imediate logjistike dhe ligjore që duhet të ndërmerren nga autoritetet vendase për të reduktuar efektet e këtij fenomeni. Kryesisht imigrantët e parregullt të kapur në territorin e Republikës së Shqipërisë rezulton të jenë të ardhur nga Bangladeshi, Afganistani, Algjeria, Eritreas, Siria, Somalia dhe Nepali. Mbi 95% e tyre janë të gjinisë mashkullore dhe të moshave nga 20-50 vjeç.

Menaxhimi efektiv i flukseve të imigrantëve të parregullt është i një rëndësie të madhe për sigurinë kombëtare, ndërkohë që vlen të priorizohen:

- a) Forcimi i masave dhe sistemeve për identifikimin dhe regjistrimin e çdo shtetasi të huaj të parregullt që hyn në territorin tonë ose tenton të kalojë tranzit përmes Republikës së Shqipërisë.
- b) Promovimin dhe rritjen e bashkëpunimit me agjencitë partnere të huaja për të shkëmbyer informacione në lidhje me identifikimin e luftëtarëve të huaj terroristë (LHT) ose individëve me lidhje me grupe të dhunshme ekstremiste, të cilët mund të fshihen brenda rrymave të përziera të migrimit. Dështimi për të identifikuar dhe adresuar me saktësi këta individë rrit rrezikun e elementëve të dhunshëm ekstremistë ose luftëtarëve të huaj terroristë që qarkullojnë brenda territorit tonë.

Për sa i përket identifikimit dhe kapjes së shtetasve të vendeve të treta që tentojnë të kalojnë tranzit nga Shqipëria në rrugë drejt vendeve të BE-së, të dhënat zyrtare reflektojnë se ka pasur një rënie prej 6280 individësh, ose një ulje prej 33,95% krahasuar me vitin 2021, e vërejtur gjatë vitit 2022. Ndërkohë që momentalisht evidentohen të dhëna të munguara për 9 mujorin e vitit 2023.

Të dhënat statistikore për vitin 2022 dhe për periudhën Janar-Qershor 2023 tregojnë se drejtimet kryesore të hyrjes në vendin tonë të shtetasve të huaj imigrantë të parregullt vijnë të evidentohen kryesisht në kufirin me Greqinë. Autoritetet përgjegjëse vendase, raportojnë se sa i takon rrugës/drejtimeve kryesore që ato ndërmarrin, vijnë të mbeten si kryesore rajoni i Korçës, kryesisht në zonën e Kapshticës; rajoni i i Gjirokastrës, kryesisht në zonën e Kakavijës dhe rajoni i Sarandës, kryesisht në zonën e Konispolit (drejtim Qafë Botë). Përdorimi i kufirit të gjelbër gjithashtu lejon kalim relativisht të lehtë, ndërkohë që kryesisht infrastruktura më e mirë rrugore në afërsi të pikës së kalimit Kakavijë e Kapshticë, synohet si një itinerar i përshtatshëm transporti drejt Malit të Zi dhe Kosovës, me destinacion vendet e BE-së e kryesisht Gjermaninë. Procesi i intervistimit ka treguar se imigrantët e parregullt e kanë të qartë synimin e tyre, itinerarin që duhet të ndjekin tranzit përmes Shqipërisë, procedurat që ndiqen për të kërkuar azil dhe më pas kalimin drejt vendeve fqinje.

Të dhënat tabelore të reflektuara në Aneksin shoqëruar të këtij Dokumenti Politikash, reflektojnë se në vitin 2022, vërehet një trend relativisht i qëndrueshëm me një rënie të lehtë midis muajve prill dhe shtator. Krahasuar me të dhënat e vitit 2021, bëhet e qartë se ky trend është në rritje. Motivimi kryesor për shtetasit që largohen nga vendet e tyre të origjinës udhëhiqet kryesisht nga papunësia, pasi ata kërkojnë perspektiva të përmirësuara në vendet e BE-së. Gjithashtu, ka individë që largohen nga vendet e tyre të origjinës për shkak të konflikteve të vazhdueshme, duke u bashkuar me familjarët që tashmë kanë nisur udhëtime të ngjashme. Në të dy skenarët, shtetasit që ofrojnë ndihmë për të realizuar këtë rrugëtim/udhëtim motivohen kryesisht nga përfitimet ekonomike.

Bazuar në të dhënat statistikore për vitin 2022, pikat kryesore të hyrjes në vendin tonë për shtetasit e huaj imigrantë të parregullt mbeten të qëndrueshme, veçanërisht në kufirin me Greqinë. Këto pika hyrëse janë si më poshtë:

- a) Qarku i Korçës ka patur 6599 imigrantëve të parregullt të identifikuar në vitin 2022. Në krahasim me vitin 2021, ku u kapën gjithsej 14,877 persona, ka pasur një rënie të dukshme prej 55,6% të numrit të imigrantëve të kapur.
- b) Në qarkun e Gjirokastrës, kryesisht në zonën e Kakavijës, gjatë vitit 2022 janë identifikuar 2,420 imigrantë të parregullt. Kjo paraqet një rritje prej 15,1% krahasuar me 2,053 personat e identifikuar në vitin 2021.
- c) Në qarkun e Vlorës, konkretisht në zonën e Konispolit (drejtimi i Qafë Botës), u identifikuan 1262 imigrantë të parregullt në vitin 2022. Kjo shënoi një rritje të ndjeshme prej 79,4% nga 259 personat e kapur gjatë së njëjtës periudhë të vitit 2021.

Bazuar në të dhënat e sipërcituara, fluksi i migracionit të parregullt është i përqendruar kryesisht në vendkalimet rrugore të qarqeve Vlorë dhe Korçë, me rreth 75% të emigrantëve të kapur të regjistruar (43% në Vlorë dhe 35% në Korçë).

Duke analizuar kohën e kapjes, është evidente se tremujori i tretë i vitit 2022 ka pësuar rritje të numrit të imigrantëve të parregullt, ku shtatori ka regjistruar shifrat më të larta. Kjo rritje e lëvizjes së imigrantëve mund t'i atribuohet shqetësimeve të tyre për motin më të ftohtë që po afrohet, gjë

që mund ta bëjë më sfidues kalimin tranzit në territorin shqiptar. Si rezultat, ata janë të motivuar të lëvizin shpejt drejt vendeve veriore të BE-së.

Nga analiza e realizuar nga vetë autoritetet institucionale përgjegjëse janë identifikuar disa faktorë të jashtëm ndikues në tendencën në rritje të numrit të imigrantëve të parregullt drejt vendit tonë, si:

- Mbyllja e rrugës së Ballkanit Verior (Maqedoni-Serbi-Hungari)
- Rritja e vazhdueshme e numrit të imigrantëve të mbërrinjë në Greqi
- Pozicioni gjeografik i vendit dhe terreni i favorshëm
- Ngritja e kampeve, nga autoritet greke në afërsi të kufirit me Shqipërinë (Janinë dhe Selanik)
- Pamundësia e kontrollit të situatës në kufi nga autoritetet greke
- Rrjetet e kontrabandimit të imigrantëve në Greqi dhe Shqipëri, të cilët bëjnë transportin deri në afërsi të kufirit
- Situata në Turqi (presionet ekonomike ose rritja e pranisë së imigrantëve), si dhe konfliktet në vendet e origjinës në Azinë Jugore/Qendrore, Lindjen e Mesme dhe Afrikën Veriore, paraqitet një faktor ndikues kryesisht gjatë 9 muajve të vitit 2023.

Procesi i verifikimit kufitar të personave në vijën e dytë është një proces po aq i rëndësishëm, sa edhe i pashmangshëm, pasi ndihmon në ofrimin e të dhënave identifikuese për bazat kombëtare dhe ndërkombëtare të të dhënave. Ndërkohë që për periudhën 9 muajve të vitit 2023, rezulton t'i jenë nënshtruar këtij procesi verifikimi minimal kufitar 117,789 shtetas të huaj, për vitin 2022 këto të dhëna janë të munguara nga ana e Departamentit për Kufirin dhe Migracionin.

Shtetasit e huaj, subjekte të këtij procesi të verifikimit në vijën e dytë, janë akomoduar në ambiente të përshtatshme për realizimin e kontrollit, ndërkohë që në përfundim të procesit të kontrollit në vijën e dytë, masat dhe hapat proceduralë realizohen në përputhje me nenet 7, 8, 9 dhe 14 të ligjit nr. 71/2016 i ndryshuar.

Masa të ndryshme administrative janë aplikuar ndaj disa prej shtetasve të huaj që i janë nënshtruar këtij procesi verifikimi. Nga të dhënat zyrtare të vëna në dispozicion rezulton se gjatë vitit 2022, janë ndëshkuar me gjobë për shkelje të afatit të qëndrimit në territor 526 shtetas, ndërkohë që në 6 muajin e vitit 2023 rezultojnë të gjobitur 220 shtetas të huaj. Parë në analizë krahasimore, nëse situata do të paraqitet e tillë deri në fund të vitit 2023, të dhënat shfaqen premtuese për një reduktim të ndjeshëm të numrit të shtetasve të huaj që shkelin parashikimet ligjore në fuqi dhe qëndrojnë në vendin tonë përtej afatit 180 ditor.

Gjithashtu, përdorimi i dokumenteve të falsifikuara me qëllim kalimin e paligjshëm të territorit vendas shtetëror, është konstatuar si një praktikë jo e munguar, me një reduktim të lehtë në vitin 2023. Më konkretisht në vitin 2022, janë ndaluar 137 shtetas të huaj të ndodhur në këtë situatë faktike, ndërkohë që 73 shtetas janë ndaluar për periudhën e parë 6 muajve të vitit 2023. Përdorimi i dokumenteve të falsifikuara, me qëllim kalimin e paligjshëm të një kufiri shtetëror paraqet sfida të shumanshme, duke përfshirë, por pa u kufizuar në kërcënimet e sigurisë kombëtare, pasojat ekonomike dhe tendosjen mbi nivelin e zbatueshmërisë së ligjit.

Mos plotësimi i kushteve për të hyrë në vendin tonë, të parashikuara në nenet 6 dhe 9 të ligjit nr. 79/2021 'Për të huajt', ka përbërë shkak për refuzimin në hyrje të 2101 shtetasve të huaj gjatë vitit 2022, ndërkohë që në 6 muajin e vitit 2023 janë refuzuar në hyrje 643 shtetas të huaj. Të dhënat e

reduktuara mbi këto raste, si dhe masat refuzuese të ndërmarra nga ana e autoriteteve përgjegjëse kufitare duhen vlerësuar pozitivisht në raport me reputacionin ndërkombëtar të vendit tonë, dhe qasjen e mekanizmave vendase ndaj zbatimit të kuadrit ligjor. Masat refuzuese duhet të shoqërohen nga vendimmarrjet e argumentuara dhe transparente, për të parandaluar keqkuptimet dhe keqinterpretimet e ligjit.

Nëpërmjet këtij Dokumenti Politikash synojmë që të informojmë publikun, lidhur me dallimin ndërmjet procesit të verifikimit të shtetasve të huaj në situatë të parregullt, të cilët konstatohen/kapen në kufi dhe atyre që konstatohen në territor:

Konstatimi/kapja e një shtetasi të huaj në situatë të parregullt në territor	Konstatimi/kapja e të huajit të parregullt në kufi
<p>Shtetasi i huaj shoqërohet nga shërbimet e policisë kufitare dhe migracionit apo shërbime të tjera të policisë së shtetit në ambientet e Komisarariatit të Policisë Kufitare apo Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin me qëllim kryerjen e procesit të përzgjedhjes nga specialisti i migracionit.</p>	<p>Nëse konstatimi/kapja e shtetasit të huaj të parregullt ndodh në kufi, punonjësi i patrullës së SPK-së kryen shoqërimin e të huajit të parregullt për në PKK nën masa sigurie. Më pas punonjësi i patrullës së SPK-së harton raportin e shërbimit duke përshkruar çdo informacion me saktësi. Procesi i përzgjedhjes në kufi bëhet nga përgjegjësi i turnit apo personeli i ngarkuar në ambientin e përcaktuar në SPK. Pasi bëhet dhe përzgjedhja, specialisti në PKK apo në Komisarariatit të Policisë Kufitare merr masat përkatëse për dërgimin e dokumentacionit të plotë në Drejtorinë Vendore për Kufirin e Migracionit.</p>
<p>Gjithmonë përpara procesi të përzgjedhjes, specialisti i migracionit kryen kontrollin e detajuar fizik. Ky kontroll bëhet për të evidencuar prova dhe të dhëna për shtetësinë ose shtetin nga ka ardhur i huaji. Gjithashtu, ndihmon në verifikimin e dokumentacionit, identifikimin e elementëve të falsifikimit, vulat e hyrjes, etj. Personat informohen mbi qëllimin e këtyre kontrolleve në gjuhën që ata e kuptojnë. Kontrolli kryhet nga një person i të njëjtës gjini dhe në respekt të plotë të parimeve të dinjitetit njerëzor, integritetit fizik dhe psikologjik.</p>	
<p>Pas kontrollit fizik, specialisti harton raportin përkatës të shërbimit dhe sipas ligjit dhe/ose akteve nënligjore ndërmerr veprimet e duhura administrative. Specialisti harton urdhrin e largimit, dëbimit dhe/ose ndalimit në Qendrën e Mbyllur. Më pas, specialisti i migracionit në Komisarariatit të Policisë Kufitare apo në Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin merr masat përkatëse për dërgimin e dokumentacionit të plotë në Drejtorinë e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin.</p>	

Procesi i përzgjedhjes së shtetasit të huaj në situatë të parregullt përfundon brenda një harku të shkurtër kohor, e më konkretisht 10 orë. Ky proces i cili realizohet nga ana e përgjegjësit të turnit/specialistit intervistues në PKK si dhe specialistit të migracionit në Komisaratin e Policisë Kufitare apo në Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin, përfshin ndër të tjera edhe marrjen e disa masave paraprake tepër të rëndësishme për realizimin e një procedure transparente, lehtësisht të kuptueshme dhe të qartë për shtetasin e huaj. Këtij të fundit i ofrohet ndihmë shëndetësore (në rast se situata e kërkon), si dhe në çdo rast garantohet informimi paraprak mbi procesin dhe procedurat që ndiqen, intervistimi individual në praninë e një përkthyesi jo të zgjedhur midis grupit të imigrantëve/refugjatëve, plotësimi dhe nënshkrimi i formularit të përzgjedhjes si dhe regjistrimi në modul nën statusin 'i huaj i parregullt' bashkërisht me shënimin mbi arsyen/et në rast të tejkallimit të afatit prej 10 orë veprimesh procedurale.

Respektimi i procedurave ligjore të sipërcituara shërben si një pikënisje në trajtimin eficient dhe garantimin e të drejtave të shtetasve të huaj të parregullt, gjatë kontaktit me administratën dhe funksionarët përgjegjës për azilin dhe migracionin. Sensibilizimi dhe përfshirja periodike e këtyre zyrtarëve në programe trajnimi do të shërbejnë pozitivisht në kuptueshmërinë e faktorëve nxitës dhe sfidave me të cilat përballen kjo kategori e shtetasve. Garantimi i një procesi rigoroz të përzgjedhjes dhe përfshirjes së përkthyesve zyrtarë të licencuar, do të shërbejë në sigurimin e neutralitetit të procesit, duke lehtësuar komunikimin efektiv ndërmjet të huajve dhe autoriteteve vendase, si dhe duke reduktuar pengesat e mundshme burokratike që mund të shfaqen. Autoritetet vendase, nëpërmjet informacionit të vënë në dispozicion, nuk kanë identifikuar tërësisht sfidat dhe pengesat me të cilat sistemi i përzgjedhjes përballlet, ndërkohë që praktika ka treguar se aksesit i shtetasve të huaj në një proces të kuptueshëm në gjuhën e tyre amtare, shpesh herë është i vështirë dhe i pamundur që të garantohet brenda afatit ligjor 10 orë. Analiza e rasteve përjashtimore, që kanë tejkalluar afatin procedural 10 orë, si dhe shkaqet/arsyet ndikuese do t'i shërbente pozitivisht mekanizmave monitorues në nivel epror për të adresuar efektivisht nevojën për rishikimin e procedurave dhe marrjen e masave shtesë për adresimin e pengesave e vakancave që mund të shërbejnë si shkak për këto vonesa.

1.4.1. Të dhëna mbi situatën dhe kapacitet funksionale të Qendrave të Përkohshme të Pritjes

Sa më lart evidentohet, KShH në asnjë prej këtyre Qendrave të Përkohshme të Pritjes nuk ka ndërmarrë vizitë monitoruese, e si rrjedhojë të dhënat e reflektuara pasqyrojnë informacionin e përcjellë nga ana e Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit.

A) Qendra e Pritjes së Migrantëve në Gërhot, DVKM Gjirokastrë

Qarku i Gjirokastrës i identifikuar nga ana e praktikës dokumentative, por edhe asaj gjyqësore, si një ndër zonat *hotspot* e preferueshme për hyrjen e imigrantëve, përfshirë edhe ato në kushte parregullsie, ka në territorin e tij të ngritura 2 Qendra të Përkohshme pritjeje. Qendra e parë pritëse me vendndodhje në ish-godinën GOS në Kakavijë, dhe e dyta pranë DVKM Gjirokastrë, funksionojnë

me kapacitet të plotë organizativ. Ajo e vendosur në zonën e ish-GOS ka një kapacitet pritjeje prej 15 shtretërisht, ndërkohë që qendra tjetër ka një kapacitet më të zgjeruar prej 60 shtretër. Paralelisht me këto 2 Qendra Pritëse, në Gjirokastrë është funksionale edhe Qendra Sociale me një kapacitet prej 15 shtretërisht. Në këtë të fundit, strehohen kryesisht kategoritë vulnerabël të imigrantëve si gratë dhe fëmijët e mitur, ose të miturit e pashoqëruar, për shkak të personelit në detyrë 24 orë.

Në analizë të të dhënave statistikore rezultoi se pas kapjes, gjatë vitit 2022, 33 shtetas të huaj janë transferuar pranë Shoqatës së Përkohshme Sociale, ndërkohë që në vitin 2021 nuk ka pasur asnjë transferim drejt këtij institucioni. Rritje e numrit të rasteve janë evidentuar gjatë 9 muorit të vitit 2023, me 32 shtetas të huaj që janë transferuar në këtë Qendër Sociale. Numri i rritjes së këtyre rasteve, rrjedhimisht vjen si pasojë e rritjes së numrit të shtetasve pjesë e kategorive vulnerabël si gratë dhe të miturit, të cilët i qasen territorit shqiptar, si një rrugë kalimi tranzit drejt vendeve evropiane.

Përpos nevojës për zhvillimin dhe zgjerimin e shërbimeve mbështetëse brenda Qendrës Sociale, duke ofruar asistencë të përshtatur që adreson nevojat specifike të shtetasve të huaj të cenusëshëm. Kjo përfshin aksesin jo vetëm në kujdesin mjekësor, por edhe mbështetjen psikologjike, mundësitë arsimore dhe trajnimin profesional të grave, duke lehtësuar integrimin e tyre në vendin tonë në rast se këta shtetas depozitojnë kërkesën e tyre për azil në vendin tonë. Gjithashtu, vlerësohet se institucionet në nivel epror sugjerohet që të marrin masa për zhvillimin e një kuadri ligjor politikash afatgjatë, duke synuar trajtimin e shkaqeve rrënjësore të flukseve migratore në përfshirjen e të cilave qëndrojnë kategoritë vulnerabël të imigrantëve. Situata të tilla ngrenë nevojën e përfshirjes në tryeza të përbashkëta diskutimi me partnerët rajonalë dhe ndërkombëtarë, si dhe vendet e origjinës, për të identifikuar rrugët e praktikave që duhen ndjekur prej tyre në përmirësimin e kushteve socio-ekonomike, ofrimin e alternativave të qëndrueshme ndaj migrimit dhe forcimin e kontrolleve kufitare për të parandaluar shfrytëzimin dhe trafikimin e migrantëve.

B) **Qendra e Pritjes së Migrantëve** në SPK Kapshticë

Qendra për Regjistrimin dhe Akomodimin e Përkohshëm për imigrantët e parregullt ka një kapacitet total prej 120 vendesh akomodimi (60 për femra dhe 60 për meshkuj), dhe përfshin 17 ambiente të kompletuara. Ndërkohë që 10 ambiente janë të përshtatura për akomodim, 1 prej tyre shërben për regjistrimin e përzgjedhjen e shtetasve të huaj, 2 për shërbime sanitare, 2 tualete, 1 kuzhinë dhe 1 lavanderi.

C) **Qendra e Pritjes së Migrantëve** në Qafë Botë, Sarandë, DVKM Vlorë

Kjo Qendër ka një kapacitet për akomodimin e përkohshëm të 60 personave.

1.4.2. Rekomandime për përmirësimin e situatës së trajtimit të fenomenit të imigracionit të parregullt

- Marrë shkas nga të dhënat e shtetasve imigrantë të parregullt recidivistë, të cilët aksesojnë në kushte paligjshmërie në mënyrë periodike kufijtë e territorit shqiptar, rekomandojmë promovimin e mundësive për hartimin e studimeve/analizave empirike duke identifikuar dhe studiuar faktorët përcaktues si kushtet e vështira socio-ekonomike, paqartësitë ligjore, ose barrierat infrastrukturore. Analiza e këtyre faktorëve impaktues do të shërbejë në përditësimin e politikave bazuar në evidenca konkrete, të cilat i shërbejnë mirë-menaxhimit të fluksit të migracionit të parregullt.
- Rekomandojmë se zbatimi i teknologjive të avancuara të mbikëqyrjes dhe përforcimi i masave të sigurisë kufitare mund të përmirësojë zbulimin dhe parandalimin e migracionit të paligjshëm të përsëritur, duke reduktuar gjasat e recidivizmit.
- Vlerësojmë se krijimi i kornizave bashkëpunuese me vendet origjinë për të trajtuar shkaqet rrënjësore të imigrimit të parregullt, si pabarazitë ekonomike, paqëndrueshmëria politike dhe trazirat sociale e konfliktet civile/luftërat, është një mekanizëm i sugjerueshëm në frenimin e migracionit të parregullt.
- Duke mbajtur në konsideratë faktin e mirë-pranuar nga ana e autoriteteve vendase përgjegjëse, si Drejtoria për Kufirin dhe Migracionin, se infrastruktura aktuale në vendin tonë nuk është e mjaftueshme për të trajtuar flukse të mëdha hyrëse të imigrantëve dhe azilkërkuesve, rekomandojmë shtimin e vëmendjes nga ana e institucioneve në nivel epror si Këshilli i Ministrave për alokimin e fondit të përshtatshëm buxhetor, me qëllim adresimin e kësaj çështjeje.
- Marrë shkas nga rezultatet e verifikimeve në vijën e dytë të shtetasve të huaj, vlerësojmë se duhen bërë përpjekje për të vlerësuar efektivitetin e masave aktuale dhe për të identifikuar çdo faktor ndikues i cili do të shërbejë në forcimin e mekanizmave të kontrollit kufitar, rritjen e procedurave të monitorimit dhe zbatimin e strategjive efektive të bashkëpunimit ndër-rajonal dhe ndërkombëtar për të parandaluar rritjen e numrit të rasteve ndaj të cilave është i parashikueshëm zbatimi i masave administrative.
- Rekomandohet zbatimi i qasjes bashkëpunuese gjithëpërfshirëse, proaktive dhe sistematike, me synim adresimin e fenomenit të përdorimit të dokumentacionit të falsifikuar për kalim të paligjshëm në territorin shtetëror shqiptar. Ndër masat që mund të ndërmerren sugjerojmë forcimin e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve institucionalë përgjegjës kombëtarë dhe ndërkombëtar për të përmirësuar mbledhjen e shkëmbimin e informacionit mbi raste të tilla; zbatimin e metodave dhe vënien në funksion të sistemeve të qëndrueshme e të avancuara teknologjike, mbi verifikimin biometrik dhe forcimin e proceseve të kontrollit në pikat e kalimit kufitar; rritjen e fushatave të ndërgjegjësimit në bashkëpunim me sektorin e shoqërisë civile për të informuar dhe edukuar qytetarët për pasojat ligjore dhe implikimet shoqërore të përfshirjes ose lehtësimit të kalimeve të paligjshme të kufirit nëpërmjet dokumenteve të falsifikuara; monitorimi efektiv i zbatimit të kuadrit ligjor rregullator me qëllim promovimin e ndëshkueshmërisë si për përdoruesit e dokumenteve të falsifikuara, por edhe për përdoruesit,

me synim parandalimin e përhapjes së këtij fenomeni.

- Refuzimi në hyrje i shtetasve të huaj që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në kuadrin ligjor vendas duhet të shoqërohet nga vendimmarrje transparente dhe të mirë-argumentuara, si dhe nga zbatimi i një qasjeje informuese ligjore ndaj shtetasve të huaj, me qëllim që ata të kuptojnë më mirë parashikimet e detyrueshme ligjore vendase. Vlen të merren masa proaktive, sipas një kalendari të mirë-organizuar, për përfshirjen e zyrtarëve të migracionit në trajnime të dedikuara mbi kuadrin ligjor të përditësuar në fuqi.

1.4.3. 'Fenomeni i kalimit të paligjshëm të kufirit dhe ndihmës ndaj tij' si një pasojë e drejtpërdrejtë e migrimit të paligjshëm, nën optikën e praktikës gjyqësore

Më herët, ekspertët e KShH-së kanë analizuar 106 vendimmarrje, të disponuara nga ana e 5 gjykatave të rretheve gjyqësore (përkatesisht ajo e Sarandës, Korçës, Shkodrës, Pogradecit dhe Përmetit), e që i përkasin periudhës kohore 7 vjeçare, 2015 – 2021, për 2 figura të veprave penale, konkretisht, "Kalimi i paligjshëm i kufirit" parashikuar nga neni 297 i K.P dhe "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve" parashikuar nga neni 298 i K.P.

Në analizë të këtij kampioni rezulton se në 86 raste, rrethanat faktike janë kualifikuar si kalim i paligjshëm i kufirit i parashikuar në nenin 297 të Kodit Penal, ndërkohë që në 5 raste me veprimet e tyre të pandehurit rezulton se kanë përmbushur edhe elementë të veprave penale "Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave" (parashikuar nga neni 189/1 K. Penal) ose në konkurrim me veprën penale të 'Ndihmës për kalim të paligjshëm të kufijve' (parashikuar nga neni 298 K. Penal). Ndërkohë në 19 raste, Gjykata ka kualifikuar veprimet e ndërmarra nga të gjykuarit si "Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit" në formën klasike, si dhe në rrethana cilësuese.

Gjykatat në zgjidhjen e çështjeve të analizuara kanë përdorur të dy llojet e gjykimeve si gjykimin e zakonshëm edhe atë të shkurtuar. Në rreth 24.5% të rasteve (ose 26 raste) është aplikuar gjykimi i shkurtuar. Lloji më i përdorur i dënimit është ai me gjobë në rreth 73% të rasteve, i ndjekur nga dënimi me burg në rreth 17% të rasteve, ndërkohë që në një numër më të ulët konsiderohet aplikimi i dënimeve alternative të dënimit me burg në 3% të rasteve. Më konkretisht, dënimi me gjobë rezulton të jetë aplikuar ndaj 77 rasteve, të kualifikuar nën veprën penale 'Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror', ndërkohë që niveli më i lartë i gjobës i dhënë nga gjykata është 150.000 lekë dhe gjoba më e ulët është 40.000 lekë.

Gjatë deklarimeve të dhëna para organeve përgjegjëse hetimore, rezulton se pjesa më e madhe e migrantëve të huaj vijnë nga Siria, ndjekur nga shtetas maroken, afgan, palestinezë dhe irakian. Migrantët detyrohen të largohen nga vendet e tyre për shkak të situatës së luftës me të cilën përballen shtetet tyre të origjinës. Ata largohen të organizuar në grupe që përbëhen nga 2 ose më shumë familje, si dhe në grupe me individë që i njohin ose për shkak të qëllimit të përbashkët për t'u larguar e kanë

përshkuar së bashku itinerarin e udhëtimit.

Konsolidimi i rrugëve të kalimit deri në momentin e mbërritjes në territorin shqiptar, është një tjetër element kyç që tregon shumë rreth mënyrës së të vepruarit. Fillimisht ata shkojnë në shtetin turk dhe më pas kalojnë kufirin me shtetin grek dhe në vazhdim drejtohen për në juglindje të vendit tonë si vendkalimi i radhës. Këto shtete përgjithësisht shërbejnë si vende tranziti dhe emigrantët në asnjë rast nuk kanë reflektuar qëllimin e tyre për të qëndruar në këto vende tranziti, por destinacioni i tyre mbeten vendet evropiane.

Tre janë vlerësuar si forma ndërveprimi ndërmjet migrantëve të huaj dhe kontrabanduesve: Takimi me kontrabanduesit, pranë pikave të kalimit kufitar, ndërkohë që me ndihmën e këtyre të fundit mundësohet përfshirja e refugjatëve në grupe të tjera më të mëdha, të cilat kanë si qëllim të përbashkët të njëjtin destinacion. 2. Identifikimi nga vetë migrantët i kontrabanduesve, ose ndihmohen nga ana e personave të tjerë që ndodhen në shtetet fqinje, të cilët më herët kanë përdorur të njëjtën mënyrë për të kaluar në mënyrë të paligjshme në një tjetër territor shtetëror; 3. Komunikimi në rrjetet sociale dhe app me kontrabanduesit, të cilët i ndihmojnë nëpërmjet njohjes me persona të caktuar ose nëpërmjet ndihmës që ju ofrohet për transport me taksì. Gjithashtu, përpunimi i të dhënave të reflektuara në vendimmarrje ka ofruar informacion sporadik rreth përfitimit financiar të kontrabanduesve, që varion nga 100-500 Euro. Nuk kanë munguar rastet kur ndihma për kalimin e paligjshëm të kufirit shtetëror është dhënë nga ana e grupeve të mirë-strukturuara, e si rrjedhojë vlera e akorduar deri në mbërritjen në destinacionin final ka qenë ajo deri në 9000 Euro.⁽³³⁾

Është konsideruar si shqetësues elaborimi i institutit të bashkëpunimit në 12 vendime nga totali i 19 vendimmarrjeve të kualifikuara nën nenin 298 K.P. Megjithatë, argumentimi i përdorur nga ana e trupave gjyqësore bazuar në konkludimet e procesit hetimor reflekton një proces sipërfaqësor, i cili nuk rezulton të ketë hedhur dritë mbi veprimtari të strukturuara kriminale të kontrabandimit të migrantëve, e si rrjedhojë mbetet kompetencë e shqyrtimit nga gjykatat me juridiksion të përgjithshëm.

Pasojat e rënda me humbjen e jetës së disa prej shtetasve që po kalonin kufirin shtetëror në mënyrë të paligjshme në kuadër të ndihmës që i ofrohej nga autorët e identifikuar, ndër të cilët foshnje e mitur dhe femër, mbetet një prej rasteve më të rënda studimore të analizuara nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Nga kampioni i vendimeve të analizuara, vetëm në 1 rast Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur pafajësinë e të pandehurit, i cili akuzohej për kryerjen e veprës penale “Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror” sipas parashikimeve të nenit 297 K.P dhe nga organi procedues është kërkuar dënimi me gjobë në vlerën 500.000 lekë. Vendimmarrja e Gjykatës vlerësohet e bazuar në fakte dhe prova, sa kohë që i pandehuri ka kaluar pa iu shmangur kontrollit kufitar nga autoritetet përgjegjëse, me mjet identifikimi pasaportën biometrike dhe nuk ka dijeni se përse nuk është regjistruar prej tyre.

Në përgjithësi, të huajt që hyjnë në territorin e vendit tonë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në ligj, kategorizohen si të huaj me qëndrim të parregullt dhe janë subjekt i masave për largimin e tyre nga territori ynë. Gjykatat, vendimmarrjet e të cilave janë marrë në analizë rezulton se nuk kanë dhënë dënime penale për të huajt që janë ndihmuar për të kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme.

⁽³³⁾ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë. Vendimi 41-2021-430,1284 datë 08.04.2021

Madje ata përmenden vetëm në analizën e rrethanave të faktit, dhe i gjithë procesi është zhvilluar në ngarkim të personit (të pandehurit) të akuzuar se ka bërë transportin e tyre, për veprën penale “Ndihe ma për kalim të paligjshëm të kufijve” parashikuar nga neni 298 i K.P. Në përgjithësi, kjo politikë e ndjekur nga Gjykatat objekt studimi në parim duket e drejtë, pasi emigrantët e parregullt duhet të trajtohen në bazë të procedurave administrative të parashikuara në legjislacionin specifik për të huajt dhe nuk duhet të jenë subjekt i ndjekjes penale të legjislacionit penal material.

Përfundim dhe në kundërshtim me praktikën pozitive të evidentuar është konstatuar vetëm 1 rast i shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec.⁽³⁴⁾ Në këtë rast, Gjykata ka dënuar penalisht me 2 muaj burg një shtetas palestinez, i cili nisur nga rrethanat e faktit të çështjes rezulton se ka kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme. Nisur nga rrethanat e ngjarjes rezulton se i pandehuri ishte nisur nga vendi i tij Palestina, me qëllim për të shkuar në vendet evropiane. Itinerari i ndjekur nga ana e të pandehurit konsistonte në kalimin e territorit turk dhe më pas atij grek. Në kufirin shtetëror turko-grek, i pandehuri konstatohet se ka takuar një shtetas sirian të cilin nuk e njohte. Ky i fundit e ka ndihmuar të pandehurin për të hipur në rimorkionin e një kamioni kundrejt pagesës. I pandehuri ka udhëtuar për 3 ditë deri në momentin që policia e gjeti gjatë kontrollit në kufirin shqiptar. Gjithashtu, nga hetimi ka rezultuar se shoferi turk i kamionit që kishte si destinacion Shkodrën nuk kishte dijeni për prezencën e shtetasit palestinez në rimorkionin e tij.

Nga ana tjetër, edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka marrë një vendim për vendosjen e masës së sigurimit me të pandehur një shtetas irakian i cili kishte statusin e azilkërkuarit.⁽³⁵⁾ Ndaj këtij shtetasi rezulton se Gjykata ka vendosur masën e sigurimit “Arrest në burg” nën akuzën “Ndihe ma për kalim të paligjshëm të kufijve” të kryer në bashkëpunim sipas nenit 298/3 të K.P. Nga analiza e vendimit gjyqësor rezulton se ky shtetas ka vepruar në rolin e organizatorit duke qenë personi me rolin kryesor midis bashkëpunëtorëve të tjerë. Arsyetimi që ka dhënë Gjykata për të pranuar kërkesën e prokurorisë për caktimin e masës së sigurimit personal, në këtë rast ka qenë i mbështetur në rrezikshmërinë e veprës penale, si dhe rrezikun e prezumuar të largimit të personit nën hetim.

1.4.4. Rekomandime nga analiza e vendimmarrjeve gjyqësore:

- Iu sugjerojmë Prokurorive të rretheve gjyqësore në juridiksionin e Gjykatave, vendimet e të cilave janë studiuar, të vlerësojnë me kujdesin e duhur elementët që nxjerrin në pah format e veçantë të bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal, me qëllim që hetimet për çështjen penale t’i kalojnë pa vonesa për kompetencë lëndore Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Duke njohur rëndësinë e veprimit të shpejtë dhe vendimtar në luftën kundër krimeve të tilla, kërkohet

⁽³⁴⁾ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, Vendimi nr.43-2021-430 datë 26.04.2021

⁽³⁵⁾ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Vendimi nr.1477 të datës 0.05.2021

një vlerësim i shpejtë dhe i përpiktë i provave dhe dëshmimeve përkatëse, duke marrë parasysh implikimet më të gjera për integritetin e sistemit gjyqësor dhe mirëqenien e shoqërisë në përgjithësi. Duke mbrojtur një tranzicion të pandërprerë në juridiksionin e specializuar të Prokurorisë së Posaçme (SPAK), është e vlerësueshme që të synohet marrja e masave për përforcimin e integritetit të proceseve ligjore dhe mbështetjen e parimeve të transparencës dhe llogaridhënies në sferën e drejtësisë penale.

- Iu sugjerojmë Gjykatave të Shkallës së Parë që t'i jepet përparësi zbatimit të ligjit specifik në rastet kur subjekt i veprës janë shtetasit e huaj në zbatim të ligjit nr.79/2021 "Për të huajt". Shtetasit e huaj duhet të konsiderohen si subjekt i largimit nga territori shqiptar dhe jo i ndëshkimit penal sipas legjislacionit tonë. Nën këtë arsyetim, nxisim marrjen e masave nga ana e instancave gjyqësore të shkallës së parë për harmonizimin e praktikës gjyqësore, me qëllimin kryesor për të mbrojtur të drejtat dhe dinjitetin e individëve, pavarësisht nga shtetësia e tyre.
- Me synim promovimin e garantimit të parimeve të transparencës dhe eficiencës së drejtësisë, iu sugjerojmë Gjykatave që t'i kushtojnë më tepër vëmendje arsytimit të vendimeve gjyqësore, duke shmangur përdorimin e formateve tip dhe gjuhës standarde dhe formale që nuk bën të mundur arsyetimin e plotë, të qartë dhe logjik të vendimit si dhe individualizimin e drejtë të dënimit. Është e domosdoshme që gjykatat të mbajnë në konsideratë argumentimet ligjore të palëve dhe reflektimin e argumenteve bindëse ligjore për pranimin ose refuzimin e tyre, mbështetur në mënyrë të individualizuar në rrethanat faktike të secilit rast. Kjo qasje, e përshtatur me rrethanat faktike unike të secilit rast, është thelbësore për të siguruar dhënien e vendimeve të paanshme dhe të mirë-argumentuara.
- Iu sugjerojmë institucioneve përgjegjëse si Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimin Kombëtar të Punësimit dhe Inspektoratit Shtetëror të Punës, koordinimin midis tyre me qëllim marrjen e masave konkrete në ndërtimin e planeve të veprimeve për aplikimin e politikave strategjike të miratuara për punësimin e të rikthyerve dhe shtetasve të dënuar për kalim të paligjshëm të kufirit për arsye punësimi, në favor të rritjes së mirëqenies së jetës së këtyre të fundit dhe riintegrimin më të lehtë e afatshkurtër të tyre në shoqëri.
- Iu sugjerojmë institucioneve përgjegjëse të sistemit të drejtësisë penale përmirësimin e zbatimit të politikës penale, nën qasjen humane, riintegruese dhe rehabilituese, lidhur me fenomenin e migrimit të paligjshëm, duke mbajtur në konsideratë faktorët nxitës dhe shtyrës, si dhe rrethanat socio-ekonomike me të cilat përballen personat nën hetim, elementë këto impaktues në fenomenin e recidivizmit.
- I sugjerojmë Drejtorisë së Përgjithshme të Kufirit dhe Migracionit, rritjen e cilësisë së mbikëqyrjes kufitare, si dhe forcimin e bashkëpunimit e ndërveprimit me agjenci ndërkombëtare si FRONTEx në përputhje me legjislacionin kombëtar, si dhe direktivat ndërkombëtare siç është Strategjia e Bashkimit Evropian mbi rikthimin vullnetar dhe riintegrimin.

Tabela 1. Viti 2022/2021 - Shtetësitë kryesore




Tabela 2. Viti 2022/2021 - Të transferuar dhe larguar vullnetarisht




Tabela 3. Viti 2022/2021 - Vendndodhja e kapjes së imigrantëve




Tabela 4. Viti 2021/2022 - Të dhëna mbi disa DVKM kryesore




Tabela 5. 9 mujori 2023/9 mujori 2022 - Shtetësitë kryesore




Tabela 6. 9 mujori 2023/9 mujori 2022 - Të transferuar ose larguar vullnetarisht




Tabela 7. 9 mujori 2023/9 mujori 2022 - Vendndodhja e kapjes së imigrantëve





Tabela 8. 9 mujori 2023/9 mujori 2022 - Të dhëna mbi disa DVKM kryesore





unicef 
for every child

C1-EU-NPA
CLUSTER ONE EU NEGOTIATIONS PLATFORM – ALBANIA



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Rr. Brigada e VIII-te, Pallati “Tekno Projekt” Shk. 2 Ap. 10, Tirana-Albania

Kutia Postare nr.1752 Tel: 04 2233671

Mob: 0694075732

E-mail: office@ahc.org.al

web site: www.ahc.org.al